

Në nivel
lokal dhe
rajonal

Raporti
Vjetor
2019

NLB Banka
Prishtina

474+ TË PUNËSUAR
LJUBLJANA
KËSHILLË FINANCIARE
SHËRBIME DIGJITALE
GARANCIONE BANKARE
PËRGJEGJËSI
SOCIALE CSR
ASETET
PROVIZIONET
DERI TANI
LEHTË
BANKINGU SARAJEVA
BANKING ONLINE
KËSHILLË FINANCIARE
NLB PAY KULETA DIGJITALE
PRISHTINA EDUKIMI FINANCIAR
35 DEGË CRM **PROFESIONAL**
DERI TANI B2B **SPONSORIME**
VEPRA TË MIRA CSR **PRISHTINA**
KËSHILLË FINANCIARE **LEHTË**
NLB M-KLIK SPONSORIME
TË HYRAT KAMATORE B2C **EKOLOGJI**
GARANCIONE BANKARE
EDUKIMI FINANCIAR
BESIM
B2B **PRISHTINA**
24/7 **WIN-WIN**
PROFESIONAL
DERI TANI SPONSORIME
WIN-WIN **BANKINGU** DIVIDENDA
SIGURI **BANKINGU** **RRITJE** **SIGURI**
SHKUP NJOHURI **PROFESIONAL** **PROFESIONAL**
NLB E-KLIK **PODGORICA** **SIGURI** 24/7 B2B
RRITJE **LEHTË** **RRITJE** **SIGURI**
NLB PAY KULETA DIGJITALE **DERI TANI** **BESIM** **NJOHURI**
BANKING MOBIL **VEPRA TË MIRA** **SHËRBIME DIGJITALE**



Në nivel lokal dhe rajonal

Raporti Vjetor 2019

Tabela e përmbajtjes

Të dhënat kryesore financiare	6
Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës	10
Mjedisi makroekonomik dhe zhvillimi i tregut	14
Spektori bankar	15
Strategjia	16
Performanca Financiare	18
Pasqyra e pozicionit financiar	22
Aktivitetet sipas segmenteve afariste	26
Afarizmi me persona juridik	26
Afarizmi me persona fizik	28
Tregjet financiare dhe operimet me pagesat	32
Teknologjia Informativë	35
Menaxhimi i Riskut	36
Përgjegjësi sociale e korporatës	37
Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	39
Qeverisja Korporative	42
Auditimi i brendshëm	45
Spektori për pajtueshmëri dhe Integritet	46
Spektori për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe Financimin e Terrorizmit (PSHP/FT)	47
Shpalosje për ngjarjet pas datës së bilancit të gjendjes	48
Pasqyrat financiare dhe Raporti i Auditorit	51

Të dhënat kryesore financiare

Tabela 1: Të dhënat financiare të NLB Banka sh.a. Prishtina

	2019	2018	2019/2018
Pasqyra e të hyrave (në EUR mijra)			
Neto të hyrat	36,788	31,889	15%
Neto të hyrat kamatore	31,014	27,513	13%
Neto të hyrat jokamatore	5,774	4,376	32%
Gjithsej shpenzimet	-11,729	-11,282	4%
Shpenzimet e punonjësve	-6,210	-5,960	4%
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	-3,738	-4,143	-10%
Zhvlërësimi	-1,781	-1,179	51%
Fitimi para provizioneve	25,059	20,607	22%
Përmirësimi i vlerave dhe provizioneve neto	-3,071	-3,794	-19%
Fitimi para tatimit	21,988	16,813	31%
Tatimi	-2,443	-1,977	24%
Fitimi pas tatimit	19,545	14,836	32%
Bilanci i gjendjes (në EUR mijra)			
Gjithsej asetet	801,085	668,128	20%
Kreditë e sektorit jo-bankar (neto)	540,073	466,854	16%
Kreditë e sektorit jo-bankar (bruto)	567,103	493,950	15%
Depozita e sektorit jo-bankar	685,385	585,851	17%
Gjithsej kapitali	84,927	71,786	18%
Indikatorët kyç			
ROE pas tatimit	25.1%	21.6%	3.5%
ROA pas tatimit	2.7%	2.4%	0.3%
RORAC para tatimit	24.4%	19.6%	4.9%
Raporti të hyra/shpenzime (CIR)	31.9%	35.4%	-3.5%
LTD (neto kreditë SJB /depozitat SJB)	78.8%	79.7%	-0.9%
Raporti i adekuatshmërisë së kapitalit (BQK)	16.4%	14.6%	1.8%
Kapitali i Klasit 1	12.7%	13.4%	-0.7%
Marzha e interesit	4.1%	4.4%	-0.3%

	2019	2018	2019/2018
Kualiteti i portofolios dhe provizionet			
Bruto kreditë jo-performuese	10,939	14,361	-24%
Raporti i KJP me gjithsej kreditë (Bankat +SJB)	1.7%	2.7%	-1.0%
Raporti i KJP të SJB	1.9%	2.9%	-1.0%
Kosto e riskut – neto (bps)	33	89	-63%
Treguesit tjerë afarist			
Pjesëmarrja në treg me gjithsej asete	17.6%	16.8%	1%
Pjesëmarrja në treg me Kreditë e SJB	18.5%	17.7%	1%
Pjesëmarrja në treg me Depozitat	17.9%	17.7%	0%
Numri i njësive afariste	35	38	-8%
Numri i bankomateve	71	66	8%
Numri i klientëve aktiv	215,633	202,632	6%
Numri i të punësuarve	474	476	0%

Shumat janë të prezantuara sipas inteksit

Përqindjet janë të prezantuara sipas differences

PROFESIONAL

BLERJA E TË ARKËTUESHMEVE

318 DEGË

PËRSOSMËRI

PROJEKTE RAJONALE DIGJITAL

QENDRA KONTAKTUESE

NLB PAY KULETA DIGJITALE

PËRSOSMËRI

SHËRBIMI MË I MIRË

NDËRMARRËSIA

INTEGRITETI

NJOHURI

KUALITETI I JETËS

BANKIER MOBIL

WIN-WIN

I PËRDITËSUAR

474+ TË PUNËSUAR

PUNËDHËNËSI MË I MIRË

STRATEGJIA

24/7

PROFESIONAL

RRITJA

BESIM

ASETET

PËRSOSMËRI

KËSHILLA FINANCIARE

Raporti i biznesit

Kapitulli 1

Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës

Viti 2019 për bankën tonë shënon performancë kulmore të një udhëtimit të vazhdueshëm të rritjes dhe rezultateve të shkëlqyeshme. Jam i lumtur të ndaj me ju, suksesin tonë në krijimin e vlerës, zhvillimin ekonomik për shoqërinë tonë, stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e bankës sonë dhe implementimin e inovacioneve të fundit në aktivitetet bankare. Do të veçoja nivele të reja të rritjes sonë, lider për nga profitabiliteti në treg dhe mbështetur nga cilësi e lart e aseteve. Ne vazhdojmë të kontribuojmë me praktikat tona të përgjegjshme të biznesit drejt prosperitetit për një gamë të gjerë të palëve të interesuara dhe komunitetit tonë në përgjithësi.

Të nderuar palë të interesuara të NLB Bankës,

Përkundër mjedisit delikate ekonomik dhe konkurrencës së lartë brenda industrisë bankare, viti 2019 shënon rezultate kulmore financiare për bankën tonë. Gjatë vitit 2019 kemi arritur qëllimin për të qenë institucioni lider në industrinë bankare me profitabilitet dhe cilësi të lart të aseteve, gjë që u mbështet edhe nga rritja dyshifrore. Ne kemi mbajtur rritje të përgjegjshme gjatë vitit 2019, duke tejkaluar objektivat tona ambicioze, duke punuar drejt misionit dhe zotimeve tona, përgjegjësisë sociale të korporatave, ndërsa vazhdojmë t'i shërbejmë klientëve tanë me krenari.

Duke qenë pjesë e një grupi të madh, të qëndrueshëm dhe fitimprurës siç është NLB, na mundëson përkushtim dhe angazhime të mëtutjeshme, të cilat i kemi dorëzuar me sukses për klientët tanë në treg. Ne kemi mundësuar bashkërisht me NLB d.d. financimi ndërkuftar të disa prej projekteve madhore në ekonominë e Kosovës, duke shënuar më tej kontribut për të qenë kampion rajonal dhe gjithnjë të përkushtuar për prosperitetin e vendit tonë. Kështu, ne kemi përmbushur angazhimet tona për ta bërë shtëpinë tonë më të mirë, ndërsa u kemi shpërndarë vlerë aksionarëve tanë në kuptim të shpërndarjes së fitimit dhe proporcionalisht duke vazhduar të jemi institucion financiar i kapitalizuar mirë dhe fleksibil, duke synuar krijimin e vlerës afatgjatë për palët e interesuara dhe komunitetin tonë.

Sfidat që kemi kapërcyer në vitin 2019, mundësojnë horizonte të reja të aktiviteteve të biznesit për bankën tonë në të ardhmen. Vizioni ynë i qartë i mbështetur me objektiva dhe qëllime, i shoqëruar me përkushtimin e ekepeve tona, pa kompromis do të lejojë që rrugëtimi ynë të forcojë themelet e rrugës sonë përpara si një institucion financiar fleksibil me një prani të fortë në treg.

Më tej, gjatë vitit 2019, banka ka vazhduar me investime kapitale të cilat mundësuan transformimin dixhital dhe përmirësimin e

cilësisë së shërbimeve tona. Përmes këtyre investimeve ne jemi më afër klientëve tanë dhe kuptojmë më mirë nevojat e tyre. Ne i konsiderojmë ekipet tona si faktorë crucial suksesi, kështu që ne mbetëm të përkushtuar në planet tona të zhvillimit të resurseve humane që promovojnë objektiva afatgjatë të institucionit tonë.

Pikat kyçe financiare do të përmbledhen shkurtimisht si në vijim:

- Banka ka realizuar fitim neto prej 19.5 milion euro që paraqet 31% tejkalim të planit vjetor, duke qenë bankë liderë në tregun bankar të Kosovës;
- Neto kreditë e sektorit jo-bankar me 31.12.2019 ishin 540 milion EUR, duke u rritur me 73 milion EUR ose 16% krahasuar me 2018;
- Efikasiteti i kostos është përmirësuar më tej siç tregohet nga raporti i të hyrave dhe shpenzimeve prej 31.9%, që ka shënuar rënie nga 35.4 % sa ishte në vitin 2018;
- Kreditë joperformuese kanë rënë nga 2.9% në 1.9% të totalit të kredive dhe kanë arritur kulmin e tij më të ulët që nga themelimi i bankës;

- Optimizimi i proceseve të brendshme është një proces i vazhdueshëm i cili mbështet rezultatet e vitit aktual duke synuar avancimin operacional.


Përveç shifrave financiare, banka gjatë vitit 2019 ka përmbushur një sërë objektivash të tjera cilësore, të cilat na bëjnë të jemi krenarë për kontributin tonë të bërë në fusha të ndryshme si aktivitete sociale, kujdesi shëndetësor, aktivitete kulturore dhe sportive.

Ne i kuptojmë sfidat që na presin, megjithatë, ne jemi gjithmonë të përgatitur të shënojmë performancë të shkëlqyer edhe në vitet e ardhshme.

Për më tepër, unë do të doja të falënderoja të gjithë punonjësit tanë - pa angazhimin, përkushtimin dhe profesionalizmin e tyre të lartë, NLB nuk mund të arrinte këto rezultate të shkëlqyera.

Të nderuar palë të interesuara të bankës, në ditët e sotme, Kosova, si pjesa tjetër e botës po merret me pandeminë e paparashikuar COVID-19 e cila ka ndikuar në shëndetin tonë, stilin e jetës, si dhe aktivitetet ekonomike. Banka ka ndërmarrë masat e nevojshme për të mbrojtur investitorët, klientët dhe punonjësit e saj, duke siguruar kushte për mbrojtje shëndetësore dhe shërbimet tona të sigurohen pa ndërprerje. Ne mbetemi të përkushtuar për të kapërcyer pengesat së bashku me klientët tanë, të cilat na paraqiten nga rrethana të tilla të pashembullta, në mënyrë që të vazhdojmë me rrugëtimin tonë drejt përmbushjes së vizionit tonë.

Juaji sinqerisht,



Kryetari i Bordit Udhëheqës
Albert Lumezi

Albert Lumezi
Kryetar i Bordit Udhëheqës



Lavdim Koshutova
Anëtar i Bordit Udhëheqës

Bogdan Podlesnik
Anëtar i Bordit Udhëheqës

** Nga Janari 2020, z. Podlesnik nuk është pjesë e Bordit Udhëheqës dhe është emëruar në pozitë tjetër në degë të Grupit NLB.*



Gem Maloku
Anëtar i Bordit Udhëheqës

** Emëruar nga Bordi i Drejtorëve të NLB-së më 18 Tetor 2019.*

Kapitulli 2

Mjedisi makroekonomik dhe zhvillimi i tregut

Gjatë vitit 2019, ekonomia e Kosovës vazhdoi të shënojë rritje pozitive ekonomike dhe tejkaloi parashikimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Burimet kryesore të financimit të rritjes ekonomike u përfshinë nga rritja e investimeve dhe burimeve të brendshme, si huazimet bankare dhe shpenzimet publike.

Edhe pse rritja ekonomike e Kosovës ka tejkaluar fqinjët e saj dhe Kosova është një nga katër vendet në Evropë që përjeton rritje në çdo vit që nga fillimi i krizës financiare globale në 2008 duke shënuar 4.2% të BPV -së, dhe kjo rritje nuk është e mjaftueshme për të reduktuar ndjeshëm shkallën e lartë e papunësisë; të ofrojë vende pune, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë; ose të ndryshojë trendin e migrimit në shkallë të gjerë. Përkundër kësaj situatë, sektori bankar ka ruajtur likuiditetin, ka rritur profitabilitetin dhe ka forcuar stabilitetin e saj duke mbajtur në nivel të lartë mjaftueshmërinë e kapitalit.

Modeli i rritjes mbështetet kryesisht në remitancat nga diaspora, e cila vazhdon të jetë një burim kryesor financiar për familjet në Kosovë.

Norma e inflacionit u karakterizua me një rritje duke arritur në 1.2%. Shkalla e inflacionit është rritur në vitin 2019 si rezultat i taksës 100% të vendosur nga Qeveria e Kosovës për produktet

e Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës. Taksa është vendosur në nëntor 2018. Lëvizja e çmimeve në Kosovë është e ngjashme me lëvizjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si rezultat i varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importet.

Tabela 2: Indikatorët makroekonomik (mesatarja e periudhës)

Kosovë	2018	2019
BPV (rritja reale në %)	3.8	4.2
Inflacioni – mesatarja për vitin (në %)	1.1	1.2
Shkalla e papunësisë (në %)	31.4	25.9
Borxhi publik (% e BPV)	17.1	17.5

Burimi: raportet e BQK dhe ASK

Borxhi publik– Kosova ka borxhin publik më të ulët në rajon në 17.5% të BPV-së më 31.12.2019 (2018: 17.1%), megjithatë në të ardhmen e afërt pritet të rritet.

Sektori bankar

Tabela 3: Sektori bankar në Kosovë (indiktorët kyç)

Banka	Periodha	Gjithsej mjetet 000 EUR	Kreditë e SJB 000 EUR	Depozitat 000 EUR	Neto fitimi 000 EUR	KJP 000 EUR	KJP %	ROE a.t. %	CAR %	CIR %	LTD %
Sektori bankar	2018	3,972,908	2,625,697	3,304,762	87,017	73,899	2.7%	20.2%	17.0%	41.5%	81.9%
	2019	4,542,006	2,913,291	3,838,522	89,453	61,439	2.0%	18.9%	15.9%	40.7%	77.6%
NLB Banka	2018	665,874	464,560	586,244	14,859	13,326	2.7%	21.6%	14.6%	36.4%	79.2%
	2019	799,428	538,425	685,979	20,386	8,360	1.5%	25.1%	16.4%	31.9%	78.5%

* Burimi: Raporti i Shoqatës së Bankave

Gjatë vitit të kaluar bankat komerciale të Kosovës i angazhuan të gjitha kapacitetet e tyre në dispozicion për të rritur sektorin privat dhe financat e ekonomive familjare, në mënyrë që Kosova të mund të ketë rritje më të madhe ekonomike, dhe të rrisë punësimin në vend. Gjatë vitit 2019, sektori bankar në Kosovë ka rritur kreditë pothuajse në të gjithë sektorët ekonomikë, dhe veçanërisht më shumë në sektorët e ndërtimit dhe prodhimit. Sistemi bankar i Kosovës është një nga punëdhënësit më të mëdhenj në sektorin privat.

Sektori bankar në Kosovë përbëhet nga 10 banka në vitin 2019 (2018: 10). Gjithsejt asetet e sektorit bankar më 31 dhjetor 2019 kanë vlerë prej 4.5 miliardë eurosh. Tetë banka me pronësi të huaj vazhdojnë të dominojnë sektorin bankar dhe menaxhojnë 87% të totalit të aseteve. Në vitin 2019, sistemi bankar operoi me fitim pas tatimit në shumë prej 89.4 milionë euro bazuar në standardet vendore.

Bankat e Kosovës janë kapitalizuar mire (brenda një raporti të mjaftueshmërisë së

kapitalit prej 15.9% më 31.12.2019), ndërsa NLB Banka ka mjaftueshmërinë e kapitalit në 16.4%.

Fitimi pas tatimit nga sektori bankar më 31 Dhjetor 2019 ishte 89.4 milion EUR (2018: 87 milion EUR). Ndërsa NLB Banka është banka kryesuese në aspektin përfitueshmërisë duke zotëruar 22.8% të fitimit neto të sektorit bankar Kosovë.

Kredite neto për SJB, NLB Banka ngrihet në Bankën e dytë më të madhe në Kosovë dhe pati një pjesëmarrje të tregut prej 18.5% (2018: 17.7%), një rritje prej 0.8% në pjesën e tregut. Rritja e kredive neto të NLB Banka në krahasim me 31.12.2018 ishte 15.9%. Rritja ishte më e lartë se sa sistemi i përgjithshëm bankar në Kosovë që ishte 11.0%.

Depozitat nga SJB me pjesëmarrje në treg prej 17.9% (2018: 17.7%) ngrihet në bankën e dytë më të madhe në Kosovë një rritje me 0.2% në pjesën e tregut. Rritja e depozitave në krahasim me një vit më parë ishte 17.0%, që paraqesin rritje më të lartë se sektori bankar që ishte në 16.2%.

LTD (Raporti Depozit Kredi) ka shënuar ulje në 78.5% sipas standardeve vendore, mirpo qëndron më mirë se mesatarja e sektorit bankar që ishte (77.6%), ndërsa ROE (Kthimi në Ekuitet pas tatimit) ka pasur përmirësim (rritje) në 25.1% krahasuar me një vit më parë (21.6%) dhe është mbi mesataren e tregut 18.9%, por me tendencë të qëndrueshme krahasuar me treguesit e tregut me luhajtje më të larta në baza vjetore.

Cilësia e investimeve bankare vazhdon të përmirësohet. Gjithsej kreditë jo-performuese në Kosovë arritën në 61.5 milionë euro, (2018: 73.9 milionë euro), dhe raporti i KJP ishte zvogeluar në 2.0% (2018: 2.7%).

Fokusimi në efikasitetin operacional dhe proceset e racionalizimit tregojnë për një CIR (raporti i shpenzimeve ndaj te ardhurave) prej 31.9% për NLB Banka, e cila është më e mirë se e sektorit prej 40.7%.

Kapitulli 3

Strategjia

Misioni dhe Vizioni

NLB Banka është në harmoni me strategjinë e ripërtërirë gjithëpërfshirëse pesë-vjeçare të grupit, duke pasqyruar ekonominë e Kosovës. Qëllimi është mbrojtja dhe forcimi i pozitës së tregut dhe pjesëmarrja aktive në rritjen dhe konsolidimin e tregut në Kosovë, digjitalizimin e mëtejshëm, rritje e konsiderueshme e fokusit ndaj klientit dhe efikasitetit të shpenzimeve. NLB Banka do të ndjekë më tej strategjinë e saj me zhvillimin e qëndrueshëm, duke ruajtur cilësi të lartë të portofolit të kreditë, stabilitet financiar, njëkohësisht duke dhënë vazhdimisht rezultate të qëndrueshme dhe duke kontribuar në shoqëri. Banka është e përqendruar në sigurimin e një niveli më të lartë të cilësisë së shërbimeve dhe prezantimin e produkteve të reja moderne. Ne do ta arrijmë këtë duke u përqendruar në nevojat e klientëve tanë dhe komunitetit në përgjithësi, duke ofruar kështu një vlerë të qëndrueshme afatgjatë për të gjithë akterët tanë.

Misioni dhe Vizioni

Brenda strategjisë së bankës, janë përcaktuar vizione dhe misione të reja, siç përcaktohet më poshtë.

Themelet e vizionit tonë janë:

- Së bashku do të kujdesemi për nevojat financiare të klientëve tanë dhe do të ndikojmë në cilësinë e jetës në vendin tonë;
 - Deri në vitin 2025, banka do të jetë një ofrues sistematik i shërbimeve përkatëse financiare të klientit në treg;
 - Ne do të përmirësojmë cilësinë e jetës në vendin tonë.
 - Themelet e misionit të ri janë:
 - Ne përpiqemi të përmirësojmë dhe zhvillojmë shtëpinë tonë së bashku për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm;
 - Ne jemi nga ky vend; prandaj, ne e kuptojmë mjedisin e tij të biznesit, zakonet dhe, mbi të gjitha: njerëzit e tij. Me angazhimin, njohurinë dhe zgjidhjet tona inovative, ne kemi kujdes të lartë për klientët tanë dhe krijojmë një jetë më të mirë, një të ardhme më të mirë për të gjithë ne;
 - Mirësevini në shtëpinë tonë.
- Më tej, Banka do të vazhdojë të zbatojë vlerat e mëposhtme të korporative brenda dhe jashtë bankës:
- Përgjegjësi ndaj klientëve, punonjësve dhe mjedisit shoqëror;
 - Angazhim për të realizuar premtimet dhe objektivat tona;
 - Moderne, inovative dhe profesionale;
 - Komunikim dhe bashkëpunim i hapur;
 - Përfitimi i ndërsjellë;
 - Efikasitet në përmbushjen e angazhimeve tona;
 - Shërbime si urë lidhëse midis tregut të Kosovës dhe tregjeve ku Grupi NLB është i pranishëm;
 - Ndërtimi i kapaciteteve të brendshme.

Strategjia e ripërtërirë e NLB Banka adreson mundësi për të nxitur rritjen dhe për të përmirësuar përfitimin e operacioneve të saj. Strategjia e re paraqet një portofolio të nismave strategjike me ndikim afatshkurtër dhe afatmesëm që do të modernizojë dhe përmirësojë operacionet e tij, do të rrisë të ardhurat, do të zvogëlojë kostot dhe do të përmirësojë perspektivat e tij të rritjes.

Ne jemi të përkushtuar të zhvillojmë një kulturë të fokusimit në klient, vetëdijesimin e riskut, integritetit, procese efikase dhe përgjegjësi sociale. Nderimi i besimit të ndërsjellë të klientëve tanë, punonjësve, aksionarëve dhe shoqërisë në të cilën ne

punojmë na jep një përgjegjësi të madhe. Duke përfshirë vlerat tona në gjithçka që bëjmë, ne kemi fuqinë për të përshtatur mjedisin tonë dhe për të kontribuar më tej në ndryshimet pozitive.

Në biznesin e saj thelbësor, Banka do të diferencojë veten duke kuptuar në thellësi klientin, duke siguruar nivel të lartë të shërbimeve dhe kompetencën këshilluese, qasje të lehtë dhe një përzierje konkurruese të produktit/ kanalit të shërbimit nën një qasje të përbashkët.

NLB Banka do të përqendrohet në përmirësimin e kënaqësisë dhe përvijës digjitale të klientit, zhvillimin dhe implementimin e zgjidhjeve të reja dhe inovative duke përdorur teknologji digjitale dhe mobile për të përmbytur nevojat e një përdoruesi modern dhe mjedisi në ndryshim.

Politika e dividendëve

Pagesa e dividendëve nga Banka do të varet nga disa faktorë, duke përfshirë strukturën e kapitalit të Bankës, apetitin e riskut, fitimet, gjendjen financiare, kërkesat rregullatore, kushtet e përgjithshme ekonomike dhe të biznesit, si dhe perspektivat e ardhshme. Politika e dividendës së Bankës parashikon shpërndarjen vjetore të dividendëve në shumën e përafërt prej 70% të rezulttit të Bankës, duke plotësuar kërkesat rregullatore dhe të apetitit të riskut.

Faktorët e rrezikut

Banka monitoron nga afër faktorët e riskut që mund të ndikojnë në rezultatin e Bankës. Ndër sfida të shumta me të cilat do të përballet Banka gjatë viteve në vijim, ekzistojnë faktorë kryesorë të riskut që do të ndikojnë në veprimtarinë e biznesit të bankës: ambienti i pafavorshëm i normës së ulët të interesit, marzhe më të ulëta të interesit, përkeqësimi i mëtejshëm i rrethanave makroekonomike dhe paqëndrueshmëria në tregjet financiare. Covid 19 do të jetë një nga sfidat më të

mëdha në vitin 2020 i cili do të ndikojë drejtpërdrejt në treguesit makroekonomikë dhe veprimtarinë e bankës.

Outlook 2020

NLB Banka do të ndjekë më tej strategjinë e saj në vitin 2020 me një zhvillim të qëndrueshëm, duke ruajtur cilësinë e lartë të portofolios kreditore, stabilitet financiar, duke forcuar fleksibilitetin e bankës, duke dhënë vazhdimisht rezultate të forta dhe duke kontribuar për shoqërinë. Banka parashikon rritje të mëtutjeshme të aktivitetit të saj në vitin 2020 dhe duke vazhduar me performancë të mirë financiare. Sidoqoftë, ndikimet e mundshme negative nga shpërthimi dhe përhapja e korona-virusit (COVID-19) nuk përfshihen në perspektivë.

Kapitulli 4

Performanca Financiare

Tabela 4: Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse

Pasqyra e të hyrave (në EUR mijra)	2019	2018	2019/2018
Neto të hyrat	36,788	31,889	15%
Neto të hyrat kamatore	31,014	27,513	13%
a) Të hyrat kamatore	34,454	30,635	12%
b) Shpenzimet kamatore	-3,440	-3,122	10%
Neto të hyrat jokamatore	5,774	4,376	32%
Neto pagesat dhe komisionet	7,373	5,472	35%
a) Të hyrat nga pagesat komisionet	10,612	7,827	36%
b) Shpenzimet për pagesat dhe komisionet	-3,239	-2,355	38%
2b) Diferencat e kursit të këmbimit valutor	17	31	-45%
2c) Neto fitimi/humbja nga asetet financiare dhe detyrimet në dispozicion për shitje	339	344	-1%
2d) Fitimet/humbjet tjera neto operative	-1,955	-1,471	33%
Gjithsej shpenzimet	-11,729	-11,282	4%
Shpenzimet e punonjësve	-6,210	-5,960	4%
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	-3,738	-4,143	-10%
Zhvlerësimi	-1,781	-1,179	51%
Fitimi para provizioneve	25,059	20,607	22%
Përmirësimi i vlerave dhe provizioneve neto	-3,071	-3,794	-19%
Fitimi para tatimit	21,988	16,813	31%
Tatimi	-2,443	-1,977	24%
Fitimi pas tatimit	19,545	14,836	32%

Fitimi


Rezultatet financiare për vitin fiskal 2019, tregojnë angazhimin e menaxhmentit dhe punonjësve të bankës për përmbushjen e një viti tjetër të suksesshëm. Në fund të vitit 2019, Banka ka tejkaluar objektivat e saj në të gjithë treguesit kryesorë, krahasuar me buxhetin, ndërsa vazhdon një performancë të shkëlqyer financiare, rritje dhe vetë-financim, cilësi të portofolit, menaxhimin e likuiditetit dhe ruajtjen e një strukture optimale të kapitalit që lejon përmbushjen e kthimit të investime shikuar nga perspektiva e aksionarit.

Fitimi neto për periudhën për vitin 2019 është 19,545 mijë EUR dhe krahasuar me 2018 është rritur me 4,709 mijë EUR ose 32%. Nxitësi kryesor për rritjen e përfitueshmërisë ishte përdorimi i fondeve drejt portofolit të SJB, duke mundësuar kthime më të larta të margjinës së interesit ndërsa ka pasur edhe përmirësim në efikasitetin e menaxhimit të kostos (CIR është nën planin dhe krahasohet me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar).

Fitimi neto sipas metodologjisë vendore (BQK) arriti në 20,386 mijë EUR. Diferenca midis SNRF-ve dhe BQK-së është 841 mijë EUR, si rezultat i diferencave për shpenzimet e provizioneve.

Rezultati financiar para provizioneve arriti në 25.059 mijë EUR dhe krahasuar me 2018 u rrit me 4,452 mijë EUR ose 22%.

Figura 1: Struktura e pasqyrës së të ardhurave 2018-2019 (000 EUR)



Të ardhura neto nga interesi

Të ardhurat neto nga interesi arritën në 31 milion EUR, krahasuar me vitin 2018 u rritën me 3.5 milion EUR ose 13%. Plani u tejkalua me 4.3 milion EUR ose 15.9% si rezultat i trendit në rritje të portofolit të kredisë. Të ardhurat nga interesi i Bankës mbizotërojnë nga të ardhurat e krijuara nga kreditë, të cilat u rritën si në segmentin e personave fizik ashtu edhe në atë të personave juridik, dhe një pjesë tjetër është si rezultat i rritjes së biznes kartelave.

Neto të hyrat jo-kamatore

Neto të hyrat jo-kamatore arritën në 5.8 milion EUR, dhe u rritën me 1.4 milion EUR, ose 32% në krahasim me vitin e kaluar, për shkak të faktorëve të mëposhtëm:

- Të hyrat më të larta neto të tarifave dhe komisioneve kryesisht i atribuohen rritjes së të ardhurave nga rritja e numrit të transaksioneve nga kartat, ATM, POS-et dhe transaksionet e-banking;
- Rritja e diferencave neto të këmbimit valutor, dhe
- Të ardhura nga shitja e pasurive financiare përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në tregun sekondar.

Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet

Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet në 2018 kanë arritur në 7.4 milion në krahasim me vitin 2018 është rritur me 1.9 milion EUR ose 35% kryesisht në mirëmbajtjen e llogarisë (prezantimi i paketave), tarifa shtesë e ATM-ve dhe garancioneve.

Figura 2: Neto të hyrat kamatore 2018 - 2019 (000 EUR)




Figura 3: Të hyrat/shpenzimet jokamatore 2018-2019 (000 EUR)





Figura 4: Të hyrat nga tarifat dhe komisionet 2018-2019 (000 EUR)



Kostot

Kostot operative arritën në 11.7 milion EUR, më të ulëta me 0.4 milion EUR ose 4% krahasur me vitin e kaluar, të ndikuara kryesisht nga kostot më të ulëta administrative.

Kostot vazhduan të ishin në fokus të vëmendjes së menaxhmentit dhe u optimizuan përmes operacioneve efektive duke përmirësuar proceset dhe kontrollet. Prandaj, CIR u ul më tej në 31.9% (2018: 35.4%) që është më e ulët se viti i kaluar me 3.5%, kryesisht për shkak të rritjes së të ardhurave dhe duke qenë gjithashtu më e ulta në sektorin bankar në vend.



Shpenzimet e stafit arritën në 6.2 milion EUR dhe krahasuar me 2018 janë më të larta me 0.3 milion EUR ose 4%.

Kostot e zhvlerësimit arritën në 1.8 milion EUR dhe janë nën planin me 0.1 milion EUR ose 7% si rezultat i disa projekteve, investimeve që u shtynë. Në krahasim me vitin 2018, është më e lartë për 0.6 milion EUR ose 51% si rezultat i qirave operative të ngarkuara për shpenzimet e amortizimit që rrjedhin nga zbatimi i SNRF 16.

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative arritën në 3.7 milion EUR dhe krahasuar me 2018 janë më të ulta me 0.4 milion EUR ose 10%, si rezultat i raportimit të shpenzimeve të qirasë në përputhje me kërkesat e SNRF 16.

Provizionet dhe rezervat për humbjet nga kredite - ishin më të ulëta se viti i kaluar me 19%. Një ulje e tillë u nxit pjesërisht si rezultat i përmirësimit të cilësisë së portofolit të kredisë. Një pjesë tjetër e rritjes në provizione ishte për çështjet juridike. Rrjedhimisht, kostoja e rezikut është zvogëluar nga -89 pika bazike në -33 pika bazike.

Figura 5: Shpenzimet operative 2018-2019 (000 EUR)



Shpenzimet e tatimit u rritën si rezultat i fitimeve më të larta në krahasim me vitet e kaluara, ndërsa shkalla e taksës prej 10% mbeti e njëjtë, megjithatë bazuar në ligjin e ri të tatimit në korporata, 20% e shpenzimeve të rezervave për humbjet nga kredit nuk janë të zbritshme për qellime tatimore, që ndikuan edhe në rritjen e shpenzimeve tatimore.

Pasqyra e pozicionit financiar

Tabela 5: Pasqyra e pozicionit financiar të NLB Bankës

Bilanci i gjendjes (000 EUR)	2019	2018	2019/2018
Gjithsej asetet	801,085	668,128	20%
Paratë e gatshme dhe bilanci me BQK	134,204	103,663	29%
Depozitat/kreditë e bankave (neto)	33,008	20,123	64%
Kreditë e sektorit jo-bankar (Bruto)	567,103	493,950	15%
Gjithsej zhvlerësimet për kreditë e SJB	-27,030	-27,096	0%
Kreditë e sektorit jo-bankar (neto)	540,073	466,854	16%
<i>Kreditë e personave juridik (neto)</i>	335,331	292,200	15%
<i>Kreditë e personave fizik (neto)</i>	204,742	174,654	17%
Letrat me vlerë	77,977	64,733	20%
Asetet fikse	14,753	11,529	28%
Asetet tjera	1,070	1,226	-13%
Gjithsej detyrimet	801,085	668,128	20%
Gjithsej detyrimet	716,158	596,342	20%
Depozitat e bankave	594	392	52%
Huamarrjet (Leasing)	38	58	-34%
Depozitat e sektorit jo bankar	685,385	585,851	17%
Depozitat e personave fizik	476,546	425,029	12%
Depozitat e personave juridik	208,839	160,822	30%
Borxhi i varur	15,010	0	-
Detyrimet tjera	15,131	10,041	51%
Gjithsej kapitali aksionar	84,927	71,786	18%
Kapitali	51,287	51,287	0%
Rezervat (përfshirë fitimin e mbajtur)	12,416	5,009	148%
Tjera	1,679	654	157%
Fitimi/humbja për periudhën	19,545	14,836	32%
Zërat kryesorë jashtëbilancor	45,120	42,006	7%
Akreditivat dhe garancionet	26,325	25,483	3%
Kreditë e shlyera në jashtëbilancore	18,795	16,523	14%

Totali i asetëve vazhdoi me trendin rrites duke arritur kulmin e tij në vlerë prej 801.1 milion euro më 31.12.2019, që është shuma më e lartë e pasqyres së pozicionit financiar që nga themelimi i Bankës. Krahasur me 31.12.2018 ka pasur rritje në totalin e asetëve me 133 milion EUR ose 20%.

Drejtuksi kryesor i rritjes së pasurive mbetet të jenë investimet drejt segmentit SJB i cili u rrit me 73.2 milion euro krahasur me vitin e kaluar.

Sipas të dhënave më 31.12.2019, NLB Banka mbetet banka e tretë më e madhe në Kosovë me pjesëmarrjen në treg prej 17.6%, krahasur me totalin e asetëve. Pjesëmarrja në kredi neto 18.5% (e rradhitur e dyta) dhe në depozita ishte 17.9% (e rradhitur e dyta).

Paraja e gatshme, bilancet me BQK dhe depozitat pa afat në banka arritën në 134.2 milion EUR. Bilancet e parashë së gatshme me BQK dhe depozitat në të parë në banka në krahasim me fundin e 2018 u rritën me 30.5 milion EUR ose 29%. Drejtuksi kryesor i kësaj rritje është për shkak të pagesave të qeverisë drejt kontraktuesve të saj.

Paraja e gatshme është mbi rezervën minimale të likuiditetit të kërkuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Depozitat me afat (Plasmanet në bankat e tjera neto) arritën në 33 milion EUR. Në krahasim me 31.12.2018, bilanci u rrit me 12.9 milion EUR ose 64%.

Letrat me vlerë arritën në 78 milion EUR dhe krahasuar me 31.12.2018 ato u rritën me 13.2 milion EUR ose 20%. Pjesa kryesore është investuar në letrat me vlerë të Borxhit të Qeverisë së Kosovës (obligacione) me maturim nga një vit deri në gjashtë vjet e gjysmë, pjesa tjetër në letrat me vlerë të SHBA dhe investimet e letrave me vlerë në VISA.

Figura 6: Gjithsej asetet dhe struktura e asetëve/detyrimeve 2018-2019 (000 EUR)





Figura 7: Pjesëmarrja në treg 2018-2019



Kreditë bruto të sektorit jo-bankar arritën në 567.1 milion EUR. Në krahasim me 31.12.2018 ajo u rrit me 73.2 milion EUR (15%).

Kreditë neto të sektorit jo-bankar arritën në 540.1 milion EUR. Në krahasim me 31.12.2018, portofoli u rrit me 73.2 milion EUR ose 16%. Struktura e kredive neto për sektorin jo-bankar konsiston në 62% të kredive për personave juridik dhe 38% të kredive për personave fizik, me strukturë të qendrueshme të kualitetit të portofolios.

Një rritje e tillë ishte nxitur nga një angazhim i jashtëzakonshëm i stafit të shitjeve, duke qenë më aktiv në treg dhe ndikimi pozitiv i fushatës së marketingut.

Raporti LTD (neto) i SBJ është zvogeluar pak në krahasim me një vit më parë duke arritur 78.8% (2018: 79.7%), i nxitur nga rritja e depozitave në fundvit.

Provizionet dhe rezervat për humbjet nga kredit - Banka vazhdoi të ketë një qasje konservatore për krijimin e provizioneve dhe rezervave për humbjet nga kredit. Shuma e provizionit arrin në 35 milion EUR, e cila u rrit në krahasim me vitin 2018 me 0.8%.

Strukture e depozitave të klientëve vazhdoi të rritet dhe ishte 86% të pasives së përgjithshme të Bankës. Depozitat e NBS arritën në 685.4 milion EUR, krahasuar me vitin e kaluar u rritën me 99.5 milion EUR ose 17%. Struktura e depozitave përbëhet nga 70% e depozitave ndaj personave fizik dhe 29% e depozitave ndaj personave juridik; 1% e mbetur janë depozitat në qeverisë.

Figura 8: Neto kreditë e SJB 2018-2019 (000 EUR)





Figura 9: Depozitat e SJB 2018-2019 (000 EUR)



Kapitali i aksionarëve

Banka vazhdoi të ishte e kapitalizuar mirë, duke ruajtur raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit prej 16.4%, që është më e lartë se minimumi i kërkuar prej 12%. Ndërsa sipas SNRF kapitali aksionar arriti në 85 milion EUR, dhe krahasuar me 2018 u rrit me 13.1 milion EUR si rezultat i fitimit neto më të lartë. Në vitin aktual, Banka ka shpërndarë si dividend shumë 7.4 milion EUR. Banka është në përputhje me rregulloren e adekuatshmerise se kapitalit te Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Takimi i Përgjithshëm i Aksionarëve u mbajt në 27 Mars 2020, ku u vendos që të mos ketë shpërndarje të dividendëve si rezultat i zhvillimit të fundit me COVID 19. Sidoqoftë, varesisht se si zhvillohet situata Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve do të analizojë më tej dhe do të reagojë menjëherë aty kur vendimi i përshtatshëm do të merret.

Kapitulli 5

Aktivitetet sipas segmenteve afariste

Afarizmi me persona juridik

18,896

Klientë ose 10.3% më shumë se në vitin 2018;

15,432

kartela debitore dhe kreditore të lëshuara për personat juridik, ose 9.9% më shumë krahasuar me vitin 2018;

7,539

përdorues të e-banking në segmentin e personave juridikë. Rritje e vazhdueshme e numrit të përdoruesve, me një rritje vjetore prej 12.7% gjatë vitit 2019;

2,292

POS, me rritje vjetore prej 19.8% gjatë vitit 2019.

Afarizmi me persona juridik është një nga aktivitetet kyçe të bankave në nivel global dhe raison d'être për industrinë bankare që luan një rol të rëndësishëm për ekonomitë të cilave ju shërbejnë. Zhvillimet në mjedisin e afarizmit bankar po shkojnë drejt një qasje të ndryshme ndaj klientëve gjatë viteve të fundit, të cilës i referohemi si gjithëpërfshirje bankare. Banka vazhdon t'i përgjigjet këtyre ndryshimeve dhe vepron si një partner strategjik për klientët e saj. Afarizmi bankar me persona juridik në të ardhmen do të jetë dixhital, i shpejtë dhe mbi të gjitha i orientuar drejt klientëve. Kjo nënkupton njohjen në mënyrë të duhur të nevojave të klientëve tanë dhe të transformohen ato në zgjidhje të shpejta dhe të thjeshta.

Bazuar në parimet që janë përmendur më lart, Banka vazhdon të ruajë pozitën e saj si një nga bankat kryesore për klientët e personave juridikë të gjitha madhësive në Kosovë, duke ju shërbyer më shumë se

18,800 ndërmarrjeve në 34 degë dhe nën degë, duke u ofruar klientëve tanë produkte dhe shërbime të ndryshme financiare, duke përfshirë kreditimin, shërbimet e pagesave, si edhe si biznesin dokumentar. Banka vazhdon të jetë një partner i besueshëm për të gjitha segmentet e ndërmarrjeve. Fokusi strategjik është rritja e mbështetjes së NVM-ve.

Aktivitetet afariste me personat juridikë përfaqësojnë pjesën më të madhe të aktiviteteve të Bankës dhe paraqesin një pjesë të lartë të rritjes totale. Ato përfshijnë kreditë afatshkurtra për nevojat aktuale, linjat kreditore, mbitërheqjet, kreditë afatgjata për financimin e projekteve investive, kreditë për ndërtimin e objekteve afariste, letër kreditë dhe garancionet, aktivitetet me depozita, shërbimet e transaksioneve të pagesave vendore dhe ndërkombëtare.

Tabela 6: Të dhënat kryesore/kyçe të aktiviteteve me persona juridik

000 EUR	2019	2018	2019/2018
Kreditë e personave juridik (neto)	335,331	292,200	15%
Depozitat e personave juridik dhe qeverisë	208,839	160,822	30%
Numri i klientëve	18,896	17,136	10%
Numri i kartelave debitor	13,706	12,316	11%
Numri i kartelave kreditore	1,726	1,750	-1%
Numri i E-banking	7,539	6,688	13%

Gjatë vitit 2019 Banka ka nënshkruar Marrëveshjen për kredi të sindikuar me BERZH, ERSTE GROUP BANK AG, NLB d.d për investime në projektin e fermës së erës në shumë prej 123 Milion EUR.

Pavarësisht nga konkurrenca e fortë, Banka ka ngritur pjesëmarrjen e tregut të portfolios kreditore të personave juridik nga 17.6% që ishte në fund të vitit 2018, në 18.3% në fund të vitit 2019. Banka ka arritur rritjen më të madhe të portfoliot kreditor të personave juridik në treg, duke rritur kreditë e personave juridik për 43.1 Milion EUR ose 15% krahasuar me fundin e vitit 2018. Rritje domethënëse kishte gjithashtu në depozitat e personave juridik dhe të shtetit për 48 Milion EUR ose 30% krahasuar me fundin e vitit 2018, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave me afat më të gjatë nga ndërmarrje private dhe publike në llogaritë e tyre rrjedhëse.

Banka gjithashtu ka siguruar optimizimin e profilit të riskut duke mbajtur një monitorim të afërt portfolion kreditor duke u fokusuar në mënyrë qendrore në ruajtjen e një portfolio cilësore kreditore. Të gjitha këto rezultate janë arritur në bazë të përparësive kyçe si më poshtë:

- Personel profesional dhe të specializuar, i përkushtuar plotësisht ndaj klientëve, duke kuptuar nevojat dhe kërkesave të tyre;
- Platformë e-banking të lehtë për përdorim për t'u siguruar klientëve mundësinë e vazhdueshme të shërbimeve të Bankës, kurdo dhe kudo;
- Gamë të gjerë e produkteve financiare të mbështetura nga produkte fleksibile, produkte të përshtatura dhe shërbime profesionale;
- Ofertë të gjerë të produkteve për klientët e personave juridik dhe fokus të rritur në segmentin e NVM-ve;
- Pozitë shumë e fortë dhe në rritje e sipër në kreditë e personave juridik.

Figura 10: Trendi i kredive dhe depozitave në afarizmin me persona juridik (000 EUR)




Figura 11: Aktivitetet kryesore bankare me personat juridik 2018-2019





Figura 12: Struktura e kredive të reja të personave juridik sipas produkteve



Afarizmi me persona fizik

327,597

Klientë – persona fizik ose 10% më shumë krahasuar me 2018;

273,259

kartela debitore dhe kreditore, të lëshuara për persona fizik, 18% më shumë krahasuar me vitin 2018;

18,402

shfrytëzues të e-banking në segmentin individual. Rritja e numrit të përdoruesve, me një rritje vjetore prej 19% në vitin 2019;

35

35 degë / nën-degë.

Afarizmi me persona fizik gjatë vitit 2019 ka vazhduar kursin e zhvillimit dhe suksesin, në përputhje me strategjinë dhe planin afarist të Bankës. Pozita e Bankës në treg renditet si një nga tri bankat më të mira në afarizmin me persona fizik në treg.

Përveç veprimtarive të rregullta në lidhje me aktivitetet bankare me persona fizik, fokusi ynë kryesor vazhdon të jetë përmirësimi i cilësisë së shërbimeve në përputhje me standardet më të larta të Grupit NLB, siç janë iniciativat strategjike, çmimet stimuluese, efikasitetin e shitjeve,

përmirësimin e eksperiencës dixhitale të klientëve dhe një fokus në shërbime këshilluese në vend të shërbimeve të transaksioneve nga degët, do të promovojë migrimin e klientëve në kanale dixhitale.

Nëpërmjet këtyre përpjekjeve dhe iniciativave të vazhdueshme ne kemi arritur zgjerimin e bazës së klientëve të personave fizik gjatë vitit 2019 si një parakusht dhe mundësi të madhe për të rritur portofolin e kredive të personave fizik dhe mbështetjen e planeve të investimeve për klientët e personave fizik, në mënyrë që klientët e personave fizik të mund të blejnë shtëpi dhe të ndërtojnë asetet e tyre familjare. Zgjerimi i bazës së klientëve të personave fizik rezultoi me rritjen e portofolios se depozitave të personave fizik, kartelave debitore dhe kreditore, përdoruesve të e-banking dhe arritjen e niveleve më të larta të kënaqësisë së klientëve, konfirmuar nga anketa e kënaqësisë së klientëve e cila është realizuar nga një kompani e jashtme.

Rrjeti i degëve: Rrjeti i degëve të NLB Banka është një faktor i rëndësishëm i të qenurit sa më afër klientëve që është e mundur. Kështu që shtrirja e degëve në 9 qytetet kryesore është një përparësi konkurruese e Bankës, duke përfshirë gjithsej 35 degë dhe nën-degë. Banka gjithashtu ka investuar në rritjen e numrit të Bankomateve në gjithsej 71 bankomate, ku 39 prej tyre janë bankomate depozitor, të vendosura në të gjitha njësitë e Bankës dhe

në të gjithë Kosovën, si dhe në vendet më të frekuentuara jashtë degëve. Këtë vit, Banka ka implementuar konceptin e ristrukturimit duke bashkuar degët në qytetin e Pejës në një degë moderne në përputhje me standardet e Grupit NLB.

Gjatë vitit 2019, Banka ka prezantuar konceptet e shitjeve që mundësuan lidhjen e marrëveshjeve trepalëshe. Ky model afarist ka mundësuar përmbushjen e nevojave të klientit dhe rritjen efikase të shitjeve. Ofrimi i produkteve përmes një marrëveshje trepalëshe ka mundësuar rolin e bankës si ndërmjetës në mes të partnerit afarist dhe klientëve të personave fizik. Kjo ka vërtetuar që NLB pozicionohet si bankë që ofron zgjidhje për klientët e personave fizik.

Secila iniciativë e shitjeve është pasuar nga fushatat e marketingut që mundësojnë komunikim efektiv me klientët. Të gjitha fushatat e marketingut kanë përdorur kanale të përshtatshme të marketingut dhe kanë ndihmuar jo vetëm shitjen e produkteve, por edhe forcimin e imazhit të Bankës.

Produktet dhe shërbimet e reja – aktivitetet kryesore:

Banka gjatë vitit 2019 është kujdesur për prezantimin e produkteve të reja si në vijim:


- Lansimi i shërbimit NLB Pay;

- Azhurimi me veçori të reja të platformës ekzistuese të e-banking;
- Lansimi i produktit kredi personale (e pasiguruar) për klientë preferencial;
- Lansimi i Master Card Debit;
- Kampanja për kredi personale deri në 30,000 me 3 muaj grejs periudhë;
- Aktivitete të vazhdueshme të shitjeve për të rritur numrin e marrëveshjeve trepalëshe - me kompani të pasurive të patundshme, mobilje, pajisje shtëpiake, universitete, sallone automjetesh të shoqëruara me fushata specifike të marketingut të publikuara në kanalet e marketingut;
- Implementimi i Efikasitetit të Forcës së Shitjes për personave fizik dhe SB;
- Implementimi i veçorive të reja të sigurisë në Mobile banking;
- Fushata të rregullta marketingu (TV, radio, portale, rrjete sociale etj.) me qëllim të mbështetjes së shitjes;
- Vazhdimi i projektit LOPA (Loan Origination Process Advancing);
- Fitimi i çmimit : “Taksapaguesi i vitit 2019”;
- Fitimi i çmimit: “NLB Banka lider në inovacion” nga Master card Direct Services;
- Lansimi i kampanjës së imazhit në nivel të Grupit NLB.

Tabela 7: Të dhënat kryesore të aktiviteteve me persona fizik

000 EUR	2019	2018	2019/2018
Kreditë e personave fizik (neto)	204,742	174,654	17%
Depozitat nga personave fizik	476,546	425,029	12%
Numri i klientëve	327,597	298,404	10%
Numri i kartelave debitor	250,008	209,706	19%
Numri i kartelave kreditore	23,251	21,646	7%
Numri i E-banking	18,402	15,401	19%

Figura 13: Trendi i kredive & depozitave në afarizmin me persona fizik: 2018-2019 (000 EUR)



Krahasuar me vitin paraprak, kreditë e personave fizik, kanë shënuar rritje për 30.1 million EUR (neto) ose 17%.

Banka ka arritur të përmirësojë pozitën në treg, është ngritur nga 17.9% në 18.8% të pjesëmarrjes në treg.

Rritja më e madhe e segmenteve të kredive në numër dhe në shumë është segmenti i kredive për banim, që përbën rreth 65%. Është e rëndësishme të theksohet që kualiteti i portfolios kreditore vazhdon të jetë i lartë. Në fund të vitit 2019, rreth 95% % e gjithsej portfolios kreditore të personave fizik ka mbetur në kategorinë "A".

Afarizmi me depozita vazhdon të jetë një linjë e qëndrueshme që dëshmon se banka është zgjedhja e duhur për klientët që vlerësojnë stabilitetin financiar të NLB Banka sh.a. Përveç uljes së normave të interesit, depozitat e personave fizik në fund të vitit 2019 arritën në 476.5 milion EUR dhe krahasuar me 2018 kanë shënuar rritje për 51.5 milion EUR ose 12%, kryesisht rritje e depozitave avista në fund të vitit 2019.

Trajtimi profesional dhe kujdesi ndaj klientëve ka shënuar rritjen e besimit të klientëve në bankë. Gjatë vitit 2019, është rritur numri i klientëve të rinj për rreth: 29,193 mijë dhe janë disbursuar 108 million EUR kredi të reja.

Figura 14: Aktivitetet kryesore bankare me persona fizik 2018-2019





Figura 15: Struktura e kredive të reja te personave fizik sipas produkteve



Kanalet moderne të shpërndarjes

Banka ka vazhduar të zgjerojë portofolion e produkteve të kanaleve moderne të shpërndarjes duke lansuar produktin më të ri në tregun e Kosovës NLB Pay dhe në këtë mënyrë duke vendosur Bankën në pozitën e Liderit të Inovacioneve në treg. Banka gjithashtu ka lansuar platformën e re të e-Banking e cila i ofron klientëve karakteristika të reja dhe interface moderne dhe të lehta për përdorim, e cila ka sjellur rritje të numrit të përdoruesve si dhe kënaqësi sa i përket cilësisë së shërbimeve.

Platforma M-Klik (Mobile Banking) e Bankës tani i ofron të gjithë përdoruesve të saj mundësinë e Menaxheri Personal të Financave për të mbajtur shënime lidhur me financat e tyre, menaxhimin e limitit të tyre ditor të kartelave dhe pagesën e borxhit të kartelave kreditore, në mesin e shërbimeve tjera.

Si rezultat i zhvillimit të kanaleve elektronike, numri i transaksioneve dhe qarkullimi nga përdorimi i kanaleve moderne të shpërndarjes nga klientët është rritur vazhdimisht. Bankomatët e Bankës kanë shënuar rritje prej 38% në vëllim dhe 27% në numër të transaksioneve, ndërsa afarizmi me POS ka shënuar rritje prej 63% në vëllim dhe 73% në numër të transaksioneve krahasuar me vitin 2018. Në mënyrë të ngjashme, është shënuar rritje në vëllimin e transaksioneve me kartela të NLB në терминаlet POS dhe bankomate për 36% dhe në numrin e transaksioneve për 40% në POS dhe 28% në bankomate. Dhe në fund por jo më pak e rëndësishme, është shënuar rritje prej 84% e numrit të transaksioneve të depozitave në bankomate dhe rritja prej 133% në vëllim të në transaksione të depozitave në bankomate.

Tregjet financiare dhe operimet me pagesat

Menaxhimi i aktivës dhe pasivës

NLB Banka ka vazhduar të menaxhojë në mënyrë efektive likuiditetin, riskun e bilancit të gjendjes së Bankës, brenda limiteve të caktuara të brendshme dhe rregullatore. Roli më i rëndësishëm është që Banka të përmbushë detyrimet e saj aktuale dhe të ardhshme dhe të jetë në gjendje t'i përmbushë ato në rrethana normale dhe të jashtëzakonshme. Risku i financimit është risku që fondet shtesë mund të merren me norma të interesit shumë të larta dhe ndonjëhere mund të mos merren fare. Financimi i NLB Banka ishte kryesisht nga diversiteti i depozitave të klientëve si burimi kryesor i financimit. Si pjesë përbërëse e menaxhimit të likuiditetit, ne monitorojmë treguesit kyç të likuiditetit, ku zhvillohet testi i stresit të likuiditetit bazuar në skenarë të zakonshëm dhe të rëndë, që na mundëson të analizojmë pozicionet e likuiditetit të Bankës për sa i përket goditjeve.

Për të ruajtur profitabilitetin e Bankës, Shërbimi i Thesarit e kontrollon atë përmes Politikës së Çmimeve efektive të transferimit të fondeve, ku njësitë organizative udhëzohen të arrijnë objektivat e tyre duke pasur një risk të centralizuar të normës së interesit.

Sa i përket likuiditetit në sektorin bankar, gjatë vitit 2019 ka pasur tepriçë të likuiditetit, që ka rezultuar me uljen e mazhës së normave të interesit. Ndikimi kryesor ka qenë nga klientët përsoneve

juridikë ka rezultuar me ulje të normave të interesit dhe marzhës së normave të interesit ku në Dhjetor të vitit 2019 në kemi arritur NIM prej 4.10% tejkalim të Planit Afarist.

Menaxhimi i likuiditetit

Për të menaxhuar riskun e likuiditetit, Banka diversifikon burimet e financimit në dispozicion dhe menaxhon aktivën në proporcion me likuiditetin, duke ruajtur bilancin e parave të gatshme dhe ekuivalentëve të saj për të përmbushur nevojat e menjëhershme të pasivës. Raportet e likuiditetit të përcaktuara nga kërkesat e brendshme dhe rregullatore monitorohen vazhdimisht. Menaxhimi i likuiditetit kryesisht është optimizuar duke investuar në aktivë shumë likuide duke përfshirë pjesëmarrjen aktive në tregun primar të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Për sa i përket tregut sekondar, ka pasur një rënie në aspektin e apetitit të investitorëve për Bono të Qeverisë së Kosovës, duke marrë parasysh që gjatë vitit 2019 kurba e fitimit shënoi një rënie e cila i bëri ato jo konkurruese në krahasim me normat mesatare të interesit të ofruara në treg për depozitat. Për më tepër, gjatë vitit 2019 kemi rritur investimet tona në Bono Thesari të SH.B.A. në mënyrë që të akomodojmë investimet tona për aktivet me risk më të ulët.

Gjatë vitit 2019, banka ka ruajtur rrjetin aktual të bankave korrespondente, ku shumica e bankave janë banka me klasifikime të larta. Ne kemi vepruar plotësisht në përputhje me limitin e sipërm

të borxhit të përcaktuar nga Metodologjia e Grupit NLB për analizën e klasifikimit kreditor dhe klasifikimit bazuar në vlerësimin ekzistues kreditor nga agjensitë ndërkombëtare të vlerësimit të kredive.

Tregu i këmbimeve valutore dhe Sistemi i Pagesave

NLB Banka menaxhon riskun e këmbimit valutor sipas Politikës së brendshme për Tregtimin me Instrumente Financiare, që është gjithashtu në pajtim me Rregulloret e Bankës Qendrore. Banka menaxhon pozitat e valutave të huaja në baza ditore dhe tregu i normave të këmbimit të valutave të huaja monitorohet rregullisht. NLB Banka është e vetmja bankë në tregun e Kosovës që ofron shërbime të këmbimit të valutave të huaja në nëntë valuta përfshirë USD, CHF, GBP, NOK, SEK, AUD, CAD, HRK dhe DKK. Meqenëse Banka nuk mban pozicione të hapura spekulative, kemi një nivel shumë të ulët të ekspozimit ndaj riskut të këmbimit valutor. Çiftet më aktive të këmbimit të valutave të cilat janë këmbyer në Bankë gjatë vitit 2019 kanë qenë EUR/CHF, EUR/USD dhe EUR/GBP. Shuma që është këmbyer gjatë vitit 2019 ishte 154 milion EUR.

Sistemet e Pagesave

OQëllimi ynë për sa i përket pagesave është t'u ofrojmë klientëve tanë zgjidhje pagese me një gamë të produkteve dhe shërbimeve. Procesimi i pagesave për klientët tanë bëhet përmes një infrastrukture profesionale që është e shpejtë dhe e sigurt, ndërsa gjatë vitit 2019 ne kemi zhvilluar disa procese

tw pagesave sa i përket shërbimeve të internetit, siç janë konfirmimet e pagesave në internet me Policinë e Kosovës.

Në fushën e transaksioneve të pagesave, në vitin 2019 janë procesuar më shumë se 2.3 milion pagesa, si dhe Banka ka arritur një qarkullim prej 3.2 miliard EUR (2018: 2.9 miliard EUR, ose 15% më shumë se në vitin 2018). Nëse krahasojmë të dhënat nga viti 2019 me vitin paraprak, është shënuar një trend të rritjes të shumës së pagesave dalëse për 16%, duke përfshirë rritjen prej 11% të numrit të pagesave. Sa i përket pagesave hyrëse, nëse krahasojmë të dhënat nga viti 2019 me të dhënat e vitit paraprak, është shënuar rritje në shumën e pagesave për 13%, përfshirë numrin e pagesave hyrëse ku është shënuar rritje prej 9%.

Sa i përket rritjet tonë të bankave korrespondente ndërkombëtare dhe duke qenë anëtarë të SWIFT, ne mund t'i drejtojmë pagesat tona ndërkombëtare në të gjithë botën në mënyrë të besueshme dhe të shpejtë.

Sa i përket pagesave ndërkombëtare, nëse krahasojmë të dhënat e vitit 2019 me vitin paraprak, është shënuar një rritje tek pagesa dalëse, në shumë të pagesave rritja është për 7%, përfshirë në numrin e pagesave ku është shënuar rritje prej 31%. Sa i përket pagesave hyrëse, nëse krahasojmë të dhënat e vitit 2019 me vitin paraprak, është shënuar një rritje në shumën e pagesave për 14%, përfshirë numrin e pagesave hyrëse ku rritja është 11%.

Pagesat ndërkombëtare kanë shënuar rritje të qarkullimit për 10%; Janë procesuar 63 mijë pagesa ndërkombëtare (2018: 53 mijë), si dhe është regjistruar qarkullim i përgjithshëm prej 1 miliardë EUR (2018: 907 milion EUR).

Figura 16: Shuma Pagesat kombëtare (000 EUR)




Figura 17: Numri i transaksioneve Pagesat kombëtare



Figura 18: Shuma Pagesat ndërkombëtare (000 EUR)





Figura 19: Numri i transaksioneve Pagesat ndërkombëtare




Biznesi Dokumentar

NLB Banka është pjesë e TFP (Trade Facilitation Program) i BERZH-it. Programi TFP i BERZH i mundësoi Bankës të vazhdojë të sigurojë biznesin dokumentar duke garantuar transaksione të vërteta tregtare midis vendeve të aktiviteteve. Garancionet dhe Letërkreditë e lëshuara gjatë vitit 2019 arritën shumën prej afro 26 milion EUR, prej të cilave rreth 18 milion EUR janë garancione ndërsa rreth 9 milion EUR janë Letërkredi. Më shumë se dyzet përqind e qarkullimit të garancioneve përbëhet nga garancionet e tenderëve, e ndjekur nga garancionet e pagesës dhe pjesa tjetër nga garancionet doganore dhe garancionet e performancës.

Portofolio e përgjithshme e Letërgarancioneve dhe Letërkredive më 31.12.2019 ishte më i lartë për 3% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Figura 20: Portfolio e letër kredive dhe garancioneve (000 EUR)



Teknologjia informative

Në vitin 2019, IT vazhdoi të luante rolin e mbështetjes së operacioneve të biznesit dhe sigurimit të efikasitetit të operacioneve. Një numër i projekteve të infrastrukturës dhe aplikimit janë zbatuar në fushën e IT për të siguruar mbështetjen e duhur të IT për proceset e biznesit dhe nismat e zhvillimit që rrisin produktivitetin, performancën, përmirësojnë përvojën e klientit, drejtojnë komunikimet dhe përmirësojnë vendimmarrjen menaxheriale.

Si pjesë e Marrëveshjes së Ndërmarrjes së Microsoft, banka është pajtuar në Office365. Në vitin 2019, parakushtet e infrastrukturës për zbatimin e Office365 janë përmbledhur përfshirë edhe konfigurimin e rrjetit. Për identitetin e saj të zgjedhur model hibrid, IT ka krijuar sinkronizimin e direktorisë midis abonimeve të tij në zona Active Directory Domain Services (AD DS) dhe Office 365 abonimin e ndjekur nga vendosja e Office 365 ProPlus, versioni i azhurnuar dhe gjithnjë aktual i Officesuite (Ëord, Excel, PoerPoint, Outlook, Skype për Biznes dhe të tjerët) në PC të përdoruesit përfundimtar "end user".

Përveç ripërtirjes së saj të serverëve, IT ka përmirësuar infrastrukturën e saj virtuale në versionin më të fundit të Vmëare vSphere dhe po i afrohet objektivit të tij të vendosur për pothuajse 100% të infrastrukturës së virtualizuar të të dhënave.

Fokus i veçantë u vu në zbatimin e zgjidhjeve me qëllim të rritjes së sigurisë në internet të Bankës. Në këtë drejtim,

Banka ka bërë investime të konsiderueshme në infrastrukturën e saj të internetit duke zbatuar IDS / IPS të Pikës së Kontrollit

IT mori pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet rajonale të Infrastrukturës së TI NLB, duke përfshirë aktivitete në zgjidhje strategjike dhe standarde në telekomunikacion, qasje të përbashkët drejt licencimit të Microsoft, zgjidhje strategjike dhe standarde për sigurinë e IT, etj. Në lidhje me këtë, një numër aktivitete kryhen si zgjedhja e shitësit për blerje të përbashkët të pajisjeve të rrjetit (çelsat e hyrjes, çelsat e grumbullimit, ruterat e degëve ËAN dhe ruterat e grumbullimit ËAN) me të cilin flota e plotë e pajisjeve të rrjetit pritet të zëvendësohet me pajisjet Juniper që mbështet SDN (Rrjetin e Definuar të Programeve), nënshkrimin e Microsoft Enterprise Marrëveshja, zgjedhja e shitësit për blerje të përbashkët të serverëve dhe softverëve të virtualizimit (Dell dhe Vmëare), përzgjedhja e shitësit për krijimin e lidhjeve të reja 1 Gbps nga databazët parësor dhe sekondar me NLB dd, vetëm për të përmendur disa.

Në vitin 2019, filloi një projekt i madh për zbatimin e një shtrese integrimi në krye të sistemit bazë. Kjo shtresë integrimi përbëhet nga lidhje API që janë të standardizuara dhe universale, kështu që Banka do të jetë në gjendje t'i (ri) përdorjë ato për të lidhur aplikime të tjera në sistemin e saj thelbësor, pavarësisht nëse ato janë siguruar nga ofruesi i sistemit bazë, i zhvilluar nga banka ose e blerë nga shitësit e tjerë. Me zbatimin e API, NLB Banka po shfrytëzon maksimumin e sistemit të saj

themelor dhe po vendos fazën për hapjen e hapur të bankave, dixhitalizimin dhe përvojën më të mirë të përdoruesit, ndërsa vazhdon të ofrojë shërbime dhe produkte të klientëve të saj janë mësuar.

Disa procese të tjera biznesi, janë mbështetur nga zhvillimi i brendshëm i TI-së me të cilat më të rëndësishmet janë zhvillimi i brendshëm i ndërfaqeve të reja në Ruajtjen e të Dhënave për Projektin e Profitabilitetit. Ekzistojnë projekte të tjera të implementuara në vitin 2019 me një mbështetje të konsiderueshme të TI si zbatimi i një platforme të re E-banking, aplikimi i letrave me vlerë, projekti LOPA, Shërbimi i Pagesave Mobile (kuleta digjitale/mobile) etj.

Kapitulli 6

Menaxhimi i Riskut

Si një institucion financiar, Banka është e ekspozuar ndaj llojeve të ndryshme të rreziqeve si pjesë e veprimtarisë së saj afariste. Kështu, menaxhimi i përgjegjshëm dhe efikas i riskut mundëson rritjen e shëndoshë dhe të qëndrueshme të bankës sonë. Duke pasur një sistem të shëndoshë të menaxhimit të riskut, ne mbështetim në mënyrë efikase përmbushjen e nevojave të klientëve, duke dhënë vlera për aksionarin dhe palët e interesit.

Ne kemi një qasje gjithëpërfshirëse drejt menaxhimit të riskut, i cili artikullohet nëpërmjet strategjisë sonë të riskut dhe apetitit të riskut. Menaxhimi i fuqishëm i riskut është i përfshirë brenda aktiviteteve ditore të bankës, përmes një strukture organizative të qëndrueshme të mbështetur dhe udhëhequr nga një strategji e shëndoshë e menaxhimit të riskut, që siguron një pasqyrë të duhur dhe llogaridhënie brenda Bankës.

Prandaj, roli kryesor i menaxhimit të riskut është reflektimi dhe zbatimi i apetitit të riskut të NLB Banka sh.a, në mënyrë të integruar dhe të qëndrueshme, e cila fillon me kuptimin e specifikave të bankës dhe specifikave të tregut, me një objektiv të vetëm të ruajtjes dhe duke kontribuar në menaxhimin efektiv dhe efikas të riskut.

Një funksion i mirë i vendosur për menaxhimin e riskut që përfshin një strukturë të drejtorëve jo-ekzekutiv dhe

ekzekutiv mundëson qeverisjen e pavarur dhe efikase të riskut. Përdorimi i modelit me tri linja të mbrojtjes në menaxhimin e riskut është shtylla kryesore e strukturës qeverisëse të riskut të Bankës.

Aktivitetet e kreditimit si një nga aktivitetet kryesore të veprimtarisë së bankës ekspozon bankën ndaj riskut kreditor, dhe që është gjithashtu nxitësi kryesor i ekspozimit ndaj riskut kreditor. Prandaj, për të krijuar një qasje të kujdesshme ndaj menaxhimit të riskut, Banka ka përdorur praktika të përafërta me strategjinë e menaxhimit të riskut të Grupit NLB dhe rregulloret e BQK-së duke njohur specifikat lokale dhe dallimet në mjedisin e biznesit që mbizotërojnë në tregun e Kosovës. Një qasje e tillë mundësoi instalimin e një sistemi efikas dhe efektiv të menaxhimit të riskut kreditor.

Risku operacional - Qëllimi i menaxhimit të riskut është të menaxhojë ekspozimin ndaj riskut operacional dhe të zvogëloj humbjet potenciale që mund të ndodhin për shkak të sistemeve të brendshme jo-adekuate, procesit të kontrollit, dobësive dhe dështimeve gjatë procesit të punës, aktiviteteve ilegale dhe ngjarjeve të jashtme të cilat mund shkaktojnë humbje për bankën. Për të mundësuar një sistem të shëndoshë të menaxhimit të riskut banka ka krijuar strukturat e duhura (Komiteti i menaxhimit të riskut operacional) dhe ka caktuar përgjegjësitë në kuadër të

strukturës organizative të bankës për të siguruar identifikimin efikas të riskut, regjistrimin, zvogëlimin dhe monitorimin e riskut operacional. Ngjarjet e dëmshme që rrjedhin nga risku operacional janë përcjellë në baza mujore, në mënyrë aktive janë monitoruar dhe raportuar tek organet e brendshme të bankës.

Detajet për Menaxhimin e Riskut duke përfshirë riskun kreditor, riskun e likuiditetit, riskun e normës së interesit, riskun e menaxhimit të kapitalit, etj, janë paraqitur në shënimin (31) në Sektorin e menaxhimit të riskut të pasqyrave të audituara financiare.

Kapitulli 7

Përgjegjësia sociale e korporatës

Aktivitetet sociale dhe mjedisore

Përgjegjësia sociale e institucioneve është një kontribut aktiv dhe vullnetar i institucionit me qëllim të përmirësimit të kushteve sociale, ekonomike dhe mjedisore dhe përmirësimit të pozitës së tyre konkurruese. Nga ky këndvështrim, NLB Banka e cila është përgjegjëse ndaj shoqërisë, ndërton në mënyrë të vazhdueshme besueshmërinë e saj, pasuron imazhin dhe duke e bërë brendin e saj më të fuqishëm, kontribuon në përfitim domethënës afatgjatë, në përmirësimin e performancës financiare, zhvillimin e aftësive të të punësuarve duke zhvilluar kështu aftësitë e të punësuarve dhe rritjen e besueshmërisë dhe preferencave të klientëve.

The social responsibility of institutions is an active and voluntary contribution of the institution with the purpose of improving social, economic and environmental conditions and improving their competitive position. From this perspective, NLB Bank which is socially responsible, continuously builds its credibility, enriches its image and makes its brand more powerful, contributes to significant long-term profitability, contributing to the improvement of financial performance, developing employee skills, increasing credibility and customer preference.

Si pjesë e Grupit NLB dhe si Bankë që vepron në Kosovë, kemi një mision të rëndësishëm për shoqërinë dhe

përgjegjësinë sociale për mjedisin në të cilin veprojmë, përveç që të arrijmë rezultate të mira financiare, ne gjithashtu kontribuojmë në një jetë cilësore për të gjithë qytetarët. Ne kemi një qëndrim të përgjegjshëm për aksionarët, punonjësit, klientët dhe gjithë shoqërinë.

Ne jemi të vetëdijshëm dhe i kushtojmë vëmendje të veçantë marrjes së njohurive të reja dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke qenë të vetëdijshëm për ndryshimet e shpejta shoqërore, revolucionin tekniko-shkencor, ku mësimdhënia tashmë është bërë një mënyrë e jetës, dhe jo vetëm përgatitja për jetën.

Ne i ndihmojmë të rinjtë në rrugën e tyre që të bëhen të pavarur financiarisht përmes leksioneve të ndryshme duke i përgatitur ata të veprojnë me përgjegjësi për një të ardhme më të suksesshme.

Ne vazhdojmë të mbështesim sportin dhe artin dhe jemi veçanërisht krenarë për pjesëmarrjen tonë tradicionale në shumë projekte humanitare që mbështesim së bashku me klientët dhe të punësuarit tanë.

Aktivitetet e ndërmarrura për përkrahjen e klientëve/ qytetarëve

NLB Banka, me përgjegjësinë e saj të punës ka arritur të fitojë besimin e klientëve, duke u munduar që gjithmonë të japë këshilla

bazuar në njohuri, ekspertizë dhe përvojë për t'i ndihmuar ata të përgatiten për gjithçka që vijon.

Me zhvillimin e shërbimeve moderne bankare, shërbimet e investimeve dhe të sigurimeve, banka u ofron klientëve shërbime që janë të përshtatshme për situatën e tyre reale financiare duke i ndihmuar ata të tejkalojnë sfidat dhe të bëjnë zgjidhjen e duhur për të ruajtur të ardhmen e tyre.

Aktivitetet lidhur me solidaritetin humanitar:

- NLB Banka ndërton një shtëpi për Familjen Hajrullahu në Gjilan;
- NLB Banka ka mbështetur Shkollën e Edukimit Special - Qendrën e Burimeve "Përparimi" në Prishtinë;
- NLB Banka ka dhuruar dhurata të Vitit të Ri për fëmijë për Shoqatën PEMA për Kujdesin e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara në Ferizaj;
- NLB Banka dhuron 10 kompjuterë në Shkollën Filllore "Gjergj Fishta" në Prishtinë;
- Të punësuarit e NLB Banka dhuruan pajisje shkollore për fëmijët në nevojë;
- NLB Banka dhuroi 10 kompjuterë në Shkollën Filllore "Ismail Luma" në komunën Lipjan / Liplljan;
- Aksion për Nëna dhe Fëmijë;
- NLB Banka kontribuoi në mini maratonën humanitare "Run Santa";
- Shënimi i ditës së personave me Sindromën Daun;
- NLB Banka kontribuoi për viktimat dhe të mbijetuarit e tërmetit që goditi Shqipërinë.

KULTURA DHE MJEDISI

Kujdesi ndaj klientit - Me miratimin e politikave dhe procedurave të kreditimit, Banka ka parandaluar financimin e projekteve të klientëve të cilët mund të rrezikojnë ndotjen e mjedisit. Banka gjithashtu i përmbahet këtyre kriterëve në lidhje me linjat kreditore të cilat Banka merr nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Të duam dhe t'a mbrojmë natyrën -

Me rastin e Ditës së Tokës, NLB Banka ka dhuruar donacion 40 drunj për komunën e Kaçanikut.

Aktivitetet kulturore dhe sportive

- NLB Banka është gjithashtu sponsor i Klubit të Futbollit Prishtinë dhe Klubit të Basketbollit “Bashkimi” në Prizren;
- NLB Banka mori pjesë në Lojërat Verore Sportive të Grupit NLB;
- NLB Banka mbështeti botimin e librit MARTIN KR PAN Diplomat dhe Ushtarak, shkruar nga Ambasadori Slloven në Shkup, Milan Jazbec.
- NLB Banka mbështet Garën e Basketbollit për perspn në
- Pjesëmarrja në Turneun e Bamirësisë në Futboll të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane
- NLB Banka është fituesi i Turneut të Bamirësisë të Dhomës Amerikane të Tregtisë;
- NLB Banka është fituesja e turneut tradicional të boëlingut të organizuar nga “Asseco SE & Banks”;
- NLB Banka organizon shahun në mënyrë simultante për nder të Ditës së Evropës;
- Klubi i Shahut Prishtina përfaqëson Kosovën në Kampionatin Evropian të Shahut;
- NLB Banka mbështeti financiarisht Garën e Përkujtimit të Shahut;
- NLB Banka ka mbështetur përfaqësuesin e Kosovës në Basketboll;
- NLB Banka sponsorizoi Streetball Kosova 2019;

Kapitulli 8

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Në NLB Banka njerëzit janë forca shtytëse e suksesit të biznesit dhe praktikata e mira të burimeve njerëzore lidhen drejtpërdrejt me të ardhurat dhe marzhet e fitimit. Planifikimi strategjik paraqet sfida dhe mundësi të mëdha për Shërbimin për Burime Njerëzore dhe Organizim në NLB Banka, i cili është i përfshirë direkt në vendimmarrje strategjike dhe merr pjesë në ekipin e strategjisë së organizimit.

Funksioni i Burimeve Njerëzore dhe Organizimit është funksion strategjik, që i orientuar nga e ardhmja e zhvillimit dhe zbatimit të programeve njerëzore që adresojnë dhe zgjidhin problemet e biznesit dhe kontribuojnë drejtpërdrejt në objektivat kryesore të biznesit afatgjatë. Ndryshimi i kushteve të tregut të punës dhe mendimi i ri i biznesit bëjnë thirrje për strategji biznesi për menaxhimi e burimeve njerëzore që përfshijnë rekrutimin dhe mbajtjen e njerëzve të duhur, si dhe sigurimin e udhëheqjes me etikë dhe integritet.

Përveç aktiviteteve me të cilat merret Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Organizim në baza ditore, gjatë vitit 2019 aktivitete kryesore kanë qenë si në vijim:

1. Zbatimi i Strategjisë së Zhvillimit të Burimeve Njerëzore dhe Organizimit për vitet 2018-2021;
2. Aprovimi dhe zbatimi i Politikës së Shpërblimit për të punësuarit që kryejnë punë speciale, ku janë përfshirë gjithsejt 20 të punësuar në pozita menaxheriale;
3. “MBO” – vazhdimi i zbatimit të menaxhimit të performancës sipas metodës “SMART” ,njedhimisht vendosja e objektivave, vlerësimi dhe shpërblimi.Nga raportet është konstatuar angazhimi i të punësuarve gjatë gjithë vitit, me rezultate shumë të suksesshme në fundvit si dhe me rezultate shumë pozitive edhe në fitimin e përgjithshëm të Bankës.
4. Trajnimet – Edhe gjatë vitit 2019 kemi vazhduar të ofrojmë trajnime dhe zhvillim të stafit të Bankës, ku numri i përgjithshëm i pjesëmarrjeve në trajnime të ndryshme brenda e Bankës, trajnime me kompani të jashtme si dhe online ka qenë 2486. Trajnimet më të rëndësishme ishin:
 - Organizimi i 2 trajnimeve të jashtme me dr. Enver Cesko, një psikoterapist i njohur në temën e Menaxhimit të Stresit Post Traumatik.
 - Kurse Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe Organizim ka organizuar dhe mbajtur 17 ditë pune trajnim interaktiv me temat Komunikimi efektiv në vendin e punës dhe Etika,
5. Motivimi dhe Vetë-Motivimi në të cilën kanë marrë pjesë 70% e të punësuarve dhe reagimet e tyre kanë qenë shumë pozitive.
5. Menaxhimi i talenteve-Gjatë vitit 2019 pas ndërmarrjes së veprimeve bazuar në Strategjinë për Menaxhimin e Talentëve janë identifikuar dhe zgjedhur grupi i talentëve mandati i të cilëve fillon më 1.1.2020 dhe zgjat deri më 31.12.2021;
6. Në vitin 2019 Banka vazhdoi bashkëpunimin me AUK, Kolegjet AAB dhe RIINVEST si dhe me studentë individualë bazuar në kërkesën e tyre për të mbajtur mësimin dhe punën praktike. Kohëzgjatja e punës praktike ishte nga 2 javë deri në 6 muaj. NLB Banka ka qenë e angazhuar të shkëmbejë praktikata më të mira bankare me të rinjtë përmes punës praktike, si dhe krijimin e mundësive, sa herë që është e mundur, në punësimin e të rinjve që përfundojnë me sukses studimet. Gjithsejt 190 studentë morën vijuan punën praktike në vitin 2019;
7. Pjesëmarrja e SCR-së në aktivitete të ndryshme sociale dhe sportive ;
8. Praktikata më të mira - Përgjatë gjithë vitit ne kemi inkurajuar politikën e dyerve të hapura duke filluar nga


Bordi Udhëheqës, dhe deri në të gjitha nivelet e pozitave menaxheriale. Me qëllim të inkurajimit të transparencës dhe komunikimit të hapur, në vitin 2019, Bordi Udhëheqës i Bankës për 2 ditë kishte “derën e hapur” ku ata e vunë veten në dispozicion të të punësuarve për të diskutuar për punën dhe jo vetëm. Reagimet e të punësuarve ishin vërtet shumë pozitive.

9. Ne kemi inkurajuar menaxherët të promovojnë iniciativa dhe të minimizojnë mikro menaxhimin dhe kemi parë rezultate shumë të mira në përmirësimin e komunikimit të përgjithshëm.

Një nga gjërat për të cilat jemi krenarë është se vazhdon që klima e mirë organizative dhe ndjenja e krenarisë për të qenë pjesë e NLB Banka. Pavarësisht nga tregu konkurrues, për të punësuarit që janë dalë nga Banka, institucionet financiare nuk kanë qenë objektivi i tyre. Ky fakt tregon se NLB Banka ka qenë dhe vazhdon të jetë një punëdhënës i dëshirueshëm në treg.

Në vitin 2019 pasur rritje të pagave bazë për të gjithë të punësuarit në mënyrë lineare për 20%.

Figura 21: Struktura e të punësuarve 2019



Kapitulli 9

Qeverisja Korporative


Qeverisja Korporative dhe

Organet Udhëheqëse

Banka ka një strukturë të qartë organizative që saktësisht përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe Organeve të tjera

udhëheqëse, të punësuarit e tjerë, si dhe të linjave të kontrollit në kryerjen e detyrave të përditshme.

Struktura organizative e Bankës është si në vijim:



Organet kryesore të Bankës janë:

- Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve,
- Bordi i Drejtorëve,
- Komiteti i Auditimit
- Komiteti i Menaxhimit të Riskut
- Bordi Udhëheqës i Bankës

Mbledhja e përgjithshme e Aksionarëve

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve të Bankës organizohet dhe merr vendime në takimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme, ku merr vendime në përputhje me ligjin. Aksionet nominale i përcaktojnë pronarëve të drejtën mbi pagesën e dividendës dhe të drejtën e votës në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve

Me 31.12.2019 (Kapitali i autorizuar aksionar i Bankës përbëhej nga 42,739 aksione të rregullta me vlerë nominale prej 1,200 EUR për aksion. Aksionari më i madh i Bankës është NLB d.d. me 81.21%, ndërsa të dhënat më të detajuara janë paraqitur në shënimet e pasqyrave financiare të audituara në kuadër të këtij raporti.

Përgjegjësitë e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve të Bankës janë të përcaktuara me Statutin e NLB Banka, të cilat janë gjithashtu në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga rregullatori.

Gjatë vitit 2019, është mbajtur 1 Mbledhje e rregullt e Përgjithshme e Aksionarëve. Mbledhja e rregullt është mbajtur më 28 mars 2019. Në takim ishin të pranishëm 92.266% të aksionarëve. Në këtë Mbledhje të Përgjithshme të Aksionarëve janë miratuar disa akte, ndër të cilat: Raporti i Auditorit të Jashtëm për vitin 2018, Plan afarist për periudhën 2019-2023, caktimi i auditorit të jashtëm për vitin 2019 si dhe ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të NLB Banka sh.a. Prishtinë.

Përbërja e Bordit të Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve zgjidhet nga aksionarët e Bankës, në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve dhe është përgjegjës pos tjerash edhe për krijimin e politikave, duke përfshirë Politikën për menaxhimin e riskut dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Bordi i Drejtorëve kryen detyrat në përputhje me dispozitat e ligjit mbi bankat dhe Statutin e Bankës.

Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2019 ka mbajtur 8 mbledhje.

Struktura e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të NLB Banka sh.a. Prishtinë më 31 dhjetor 2019, ishte si në vijim:

- Z. Andreas Burkhardt, kryesues
- Znj. Hedvika Usenik, zëvendës kryesuese
- Z. Andrej Baričić, anëtar
- Z. Abdylmenaf Bexheti, anëtar
- Znj. Ardiana Bunjaku, anëtare
- Z. Albert Lumezi, member – anëtar – Kryetar i Bordit Udhëheqës të NLB Banka sipas funksionit pa të drejtë vote.

Komiteti i Auditimit

Anëtarët e Komitetit të Auditimit me datë 31 dhjetor 2019 ishin si në vijim:

- Z. Andrej Baričić, Kryetar i Komitetit të Auditimit
- Znj. Ardiana Bunjaku, anëtare e Komitetit të Auditimit
- Z. Borislav Atanasovski, anëtar e Komitetit të Auditimit

Komiteti i Auditimit është themeluar në bazë të Ligjit për bankat ndërsa puna dhe aktivitetet e saja janë përcaktuar në Rregulloren e Punës së Komitetit të Auditimit. Komiteti i Auditimit mban së paku një mbledhje në çdo tre muaj. Gjatë vitit 2019 janë mbajtur gjithsej pesë (5) mbledhje.

Fushat e mbuluara nga Komiteti i Auditimit janë: miratimi i raporteve të auditimit të brendshëm, vlerësimi i procedurave të auditimit, vlerësimi i kontroleve të brendshme, rishikimi i raportit të pajtueshmërisë, rishikimi i performancës financiare të bankës, rishikimi i letër rekomandimit të auditorëve të jashtëm dhe pasqyrat financiare të audituara. Përveç kësaj, komiteti i auditimit gjithashtu bën njohjen, vlerësimin dhe miratimin e rekomandimeve dhe nxjerr vendime lidhur me dokumentet e rregullatorit të jashtëm.

Komiteti i Riskut

Më datë 31 dhjetor 2019 anëtarët e Komitetit të Riskut ishin si në vijim:

- Z. Andreas Burkhardt, Kryesues
- Znj. Ardiana Bunjaku, anëtare
- Z. Abdylmenaf Bexheti, anëtar

Komiteti i Menaxhimit të Riskut është themeluar në bazë të Ligjit për bankat dhe funksionon në bazë të Rregullores së brendshme të Komitetit për Menaxhimin e Rrezikut.

Komiteti i menaxhimit të rrezikut ndihmon Bordin e Drejtorëve me fokus të specializuar në fushën e menaxhimit të riskut. Në Komitet janë anëtarë tre drejtorë jo-ekzekutiv.

Komiteti i menaxhimit të riskut mban së paku një mbledhje në çdo tre muaj në mënyrë që të monitorojë ekspozimin ndaj riskut dhe menaxhimin e riskut të Bankës. Gjatë vitit 2019 janë mbajtur gjithsej katër (4) mbledhje. Komiteti si i tillë mbikëqyr fushën e riskut kreditor, riskut të tregut dhe riskun operacional, me qëllim të zbatimit efikas dhe efektiv të apetitit të administrimit të riskut dhe strategjisë së riskut të NLB Banka.

Përbërja e Bordit Udhëheqës të Bankës

Bordi Udhëheqës i Bankës, udhëheq, përfaqëson dhe vepron në emër të Bankës, në mënyrë të pavarur dhe me vetë-përgjegjësi, ashtu siç parashihet me Statutin e Bankës. Kryetari dhe anëtarët emërohen me mandat katër vjeçar me mundësi të rizgjedhjes, në përputhje me kushtet e përcaktuar me Ligji dhe Statutin e Bankës.

Bordi Udhëheqës i NLB Banka përbëhet nga tre persona:

- Z. Albert Lumezi, aKryetar i Bordit Udhëheqës
- Z. Bogdan Podlesnik, anëtar i Bordit Udhëheqës
- Z. Lavdim Koshutova anëtar i Bordit Udhëheqës.

Me qëllim të sigurimit të funksionimit të duhur të afarizmit të Bankës si dhe monitorimin e aktiviteteve të rregullta, brenda Bankës gjithashtu veprojnë këto Komitete:

- Komitetit për menaxhimin e Aktivës dhe Pasivës (ALCO - brenda komitetit ALCO është themeluar nën-komiteti i quajtur Komiteti i çmimeve)
- Komiteti kreditor
- Komiteti për Menaxhimin e Riskut Kreditor
- Komiteti i Sigurisë
- Komiteti për Menaxhimin e Riskut Operacional
- Komiteti i TI-së
- Komiteti për Punë të Personelit
- Komiteti i Prokurimit
- Komiteti i Marketingut.
- Komiteti i parandalimit të shpëlarjes së parave
- Komiteti për menaxhimin e të dhënave

Kapitulli 10

Auditimi i Brendshëm

Funksioni i auditimit të brendshëm në NLB Banka kryhet nga Sektori i Auditimit të Brendshëm. Sektori i Auditimit të Brendshëm është funksion i pavarur në bankë që në aspektin funksional i raporton direkt Komitetit të Auditimit të Bordit të Drejtorëve të Bankës, ndërsa në mënyrë administrative i raporton një anëtar të Bordit Udhëheqës të Bankës. Objektivi kryesor i Sektorit të Auditimit të Brendshëm është të ofrojë siguri objektive dhe këshilluese me qëllim të shtimit të vlerës dhe përmirësimit të proceseve në Bankë. Kjo arrihet duke përdorur një qasje sistematike dhe profesionale për të vlerësuar dhe përmirësuar menaxhimin e riskut, sistemin e kontrollit të brendshëm, qeverisjen dhe efikasitetin e operacioneve të bankës. Auditimi i brendshëm jep një kontribut të rëndësishëm për Bankën për të përmbushur objektivat e saj strategjike dhe afariste dhe për të aplikuar praktikat më të mira bankare.

Metodologjia e punës së Auditimit të Brendshëm, kompetencat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara në rregulloren për Auditimin e Brendshëm në NLB Banka Prishtinë dhe Metodologjinë e Auditimit të Brendshëm, të cilat janë plotësisht në përputhje me standardet e Auditimit të Brendshëm në NLB d.d., praktikat më të mira ndërkombëtare të auditimit, si dhe ligjet dhe rregulloret e Kosovës lidhur me auditimin.

Auditimi i brendshëm funksionon dhe është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm dhe me Kodin e Etikës së auditimit të brendshëm dhe Rregullat dhe Rregulloret e Kosovës.

Sektori i Auditimit të Brendshëm përbëhet nga katër punonjës. Aktivitetet e auditimit të brendshëm kryhen në përputhje me Planin e Auditimit të Brendshëm, i cili përgatitet në baza vjetore duke përdorur një qasje të bazuar në risk në përputhje me qëllimet dhe objektivat e Bankës. Qasja e bazuar në risk përdoret gjithashtu në përcaktimin e fushës së auditimit të secilit angazhim të planit të auditimit, përfshirë kohën dhe shpërndarjen e burimeve. Secili Plan i Auditimit të Brendshëm miratohet nga Komiteti i Auditimit të Bankës. Plani i Auditimit të Brendshëm azhurnohet rregullisht për të pasqyruar ndryshimet përkatëse që adresojnë rreziqet kryesore të bankës në një moment të caktuar kohor.

Raporti i auditimit të brendshëm kryesisht përbëhet nga opinion i auditorit të brendshëm, gjetjet, shkaqet, rreziqet dhe rekomandimet, si dhe veprimet për të cilat është rënë dakord të ndërmerren nga pronari i procesit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna. Raportet miratohen nga Komiteti i Auditimit të Bankës në baza tremujore. Rekomandimet e dhëna në raportet e auditimit përcillen

rregullisht dhe raportohen në Bordin Udhëheqës, si dhe në Komitetin e Auditimit të Bankës.

Auditimi i Brendshëm vazhdimisht bashkëpunon me Auditimin e Brendshëm të NLB dd në lidhje me auditimet e përbashkëta, auditimet e kryera në nivel grupi si dhe metodologjinë e punës së auditimit. Përveç kësaj, raportimi tremujor paraqitet në Auditimin e Brendshëm të NLB dd në lidhje me vëzhgimet kryesore, rekomandimet e vonuara si dhe rekomandimet kyçe të dhëna nga rregullatorët. Më në fund, Auditimi i Brendshëm ofron raporte të auditimit të brendshëm për auditorët e jashtëm dhe palët e jashtme (policia, kompanitë e sigurimeve dhe rregullatori) sipas kërkesës së tyre.

Kapitulli 11

Sektori për Pajtueshmëri dhe Integritet

Pajtueshmëria dhe Integriteti është sektor i pavarur në Bankë që informon dhe këshillon menaxhmentin e lartë dhe raporton pranë Bordit të Drejtorëve (përmes Komitetit të Auditimit). Korniza ligjore dhe integriteti i sektorit të pajtueshmërisë është krijuar në përputhje me kërkesat e Standardeve minimale të Pajtueshmërisë dhe Integritetit të Grupit NLB, dhe Rregullores për Qeverisjen Korporative të Bankave (rregullorja lokale). Sektori përbëhet nga dy të punësuar – Drejtori i Sektorit dhe një zyrtar i lartë i pajtueshmërisë.

Në përgjithësi, aktivitetet e realizuara të pajtueshmërisë dhe integritetit mbulojnë zbatimin e detyrave sipas planit vjetor të punës 2019, zbatimin e rekomandimeve të nxjerra nga Linja e Pajtueshmërisë NLB dd, zbatimin e rekomandimeve të Vlerësimit të Riskut të Komopanisë, rishikimin e rregullt dhe azhurnimin e akteve të brendshme të Sektorit të Pajtueshmërisë dhe Integritetit në lidhje me zbatimin e Standardeve (Standardet e Pajtueshmërisë dhe Integritetit në Grupin NLB).

Aktivitetet tjera me rëndësi të zhvilluara nga Sektori për Pajtueshmëri dhe Integritet gjate vitit 2019 janë:

- Sektori i Pajtueshmërisë dhe Integritetit i NLB Banka Prishtinë, ka kryer vlerësimin e rrezikut të pajtueshmërisë së kompanisë - azhurnimin për vitin 2019, bazuar në

Udhëzimet për Zbatimin e Vlerësimit të Riskut të Komopanisë në NLB Banka sh.a., Prishtinë (gusht 2019);

- Përfundimi i Anketës mbi Pajtueshmërinë dhe Integritetin – Anketa mbi Etikën dhe Pajtueshmërisë për herë të parë është realizuar në Qershor 2018 për të përcaktuar perceptimet e punonjësve për gjendjen e pajtueshmërisë dhe etikës në bankë, vëzhgimet e tyre, sugjerimet për përmirësime dhe qëndrimet ndaj praktikave specifike . Për të monitoruar ndikimin e etikës dhe veprimtarive të ndryshme të Bankës, ne e kemi përsëritur atë në gusht 2019;
- Mësimi i rregullt elektronik vjetor mbi Pajtueshmërinë dhe Integritetin - e-mësimi elektronik mbi Etikën, Integritetin dhe Kodin e Sjelljes, Parandalimin e konfliktit të interesit dhe korrupsionit, Parandalimin e sjelljeve të gabuara dhe sjelljeve të dëmshme;
- Njofimi elektronik në lidhje me detyrimet e punonjësve në lidhje me marrjen dhe dhurimin e dhuratave, në lidhje me kryerjen e funksioneve / aktiviteteve jashtë Bankës, parandalimin e konfliktit të interesit, në lidhje me kanalet raportuese dhe mbrojtjen e informatorëve;
- Avancimi i sistemit për monitorimin e ndryshimeve në mjedisin juridik - buletinet periodike mbi ndryshimet rregullatore, vlerësimin e ndikimit në biznes në bashkëpunim me njësitë organizative (pronarët e procesit);
- Mbështetja e NJO-ve duke dhënë mendime, këshilla dhe propozime për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme bankare;
- Hetimi i rasteve të dyshuara të sjelljes së dëmshme;
- Vlerësime për të gjithë mbajtësit e funksioneve kryesore rregullisht dhe sipas standardeve të NLB;
- Aktivitetet e marrëdhënieve me investitorët bazuar në Rregullat për Informimin e Brendshëm - Komunikim me punonjësit në lidhje me periudhën e mbyllur (periudha gjatë së cilës ata janë të ndaluar të marrin pjesë në transaksione që përfshijnë aksione dhe instrumente të tjera financiare të NLB d.d., Ljubljana);
- Aplikacioni Whistler - është një aplikacion i ri i zhvilluar për raportimin e sjelljeve të zbuluara që lejojnë personin raportues të paraqesë një raport të zbuluar ose anonim në mirëbesim. Whistler siguron plotësisht që personi raportues do të mbrohet nga masat hakmarrëse eventuale që ai mund të marrë.

Kapitulli 12

Sektori për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe Financimin e Terrorizmit (PSHP/FT)

Banka është plotësisht në dijeni të kërkesave të PSHP/FT si në nivel lokal dhe ndërkombëtar dhe kupton rreziqet e SHP / FT. Në këtë drejtim, banka implementon politikën e tolerancës zero ndaj përdorimit të produkteve dhe shërbimeve tona bankare për qëllime të paligjshme. Sektori për PSHP/FT ka vazhduar me adaptimin e vazhdueshëm të politikave dhe procedurave në përputhje me kërkesat e reja ligjore për PSHP/FT dhe standardet e Grupit NLB, gjate vitit 2019 fokusi kryesor ishte në harmonizimin e politikave me NLB Grup sipas kërkesës së Bankës së Sllovenisë si dhe trajnimin dhe ndërgjegjësimin e të punësuarve në temat e caktuara me qëllim të ngritjes së vetëdijes për identifikimin e aktiviteteve të pazakonshme/dyshimta. Këto masa kanë rezultuar në 119% rritje të Raportit të transaksioneve të Dyshimta në NJIF. Në koordinim dhe mbështetje të CSKPI, aktivitetet tjera të rëndësishme:

- Në bashkëpunim me Divizionin përsonave fizik entimi i SËIFT KYC Registry;
 - Ndryshimi i procesit të monitorimit të transaksioneve nga paralelja aktuale (monitorimi në njësitë afariste) në vetëm SironAML;
 - Miratimi i Politikës për pranimin e ushtrimit të biznesit me klientë me rrezik të lartë dhe apetitutin e rrezikut për PSHP/PT në NLB Prishtina;
 - Miratimi i Politikës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (Standardet në nivel Grupi);
 - Trajnim të zgjeruar për të punësuarit që punojnë direct në shitje
- Aprovimi i procedures së re për Parandalimin e Shpërlarjes së Parasë dhe Financimin e Terrorizmit;
 - Në bashkëpunim me Divizionin përsonave fizik implementimi i Projektit për azhurnimin e të dhënave të klientëve dhe profilon e tyre bazuar në principin “Njihe Klientin Tënd”;

Shpalosje për ngjarjet pas datës së bilancit të gjendjes

Pas indikacioneve të shpërthimit të korona virusit - COVID-19 (në tekstin e mëtejme korona virus) në Mars në Republikën e Kosovës, NLB Banka j.s.c. në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Banka) ka ndërmarrë masat e nevojshme për të mbrojtur investitorët, klientët dhe punonjësit e saj, duke siguruar kushte të sigurta dhe duke siguruar që shërbimet të ofrohen pa ndërprerje. Përderisa shpërthimi dhe përhapja e korona virusit vazhdon të evoluojë, është sfiduese të

parashikohet shtrirja dhe kohëzgjatja e plotë të ndikimeve të saj në biznes dhe ekonomi. Rrjedhimisht, këto rrethana mund ta paraqesin sfida për bankën që lidhen me veprimtarinë e biznesit në një pjesë të madhe për shkak të masave dhe politikave të organeve qeveritare përkatëse të cilat tashmë janë zbatuar ose mund të zbatohen në të ardhmen. Masat dhe politikat e tilla mund të ndikojnë ndjeshëm aktivitetet e bankës, kështu që banka do të marrë në konsideratë masat zbatuese për

të mbështetur ekonominë në Republikën e Kosovës. Banka vlerëson se korona virusi mund të ketë efekt negativ në portofolin e kredisë, cilësinë e aseteve, zhvlerësimet dhe provizionet, matjen e vlerës së drejtë të aseteve financiare, etj. Shkalla e ndikimit në performancën financiare të Bankës, aktualisht nuk është e mundur të vlerësohet me një shkallë të lartë të sigurisë.

PARAJA E GATSHME
KONTABILITETI
KAPITALI AKSIONAR
TARIFAT

TARIFAT
RAPORTET
MARRËVESHJET

INTEREST INCOME
DEGËT
KAPITALI AKSIONAR
TATIMET

VALUTA

PASQYRAT FINANCIARE
ADEKUATSHMËRIA E KAPITALIT

TREGUESIT E PËRFORMANCËS

MARRËVESHJET
ZHVLERËSIM
KREDI

SEGMENT
MENAXHIMI I RISKUT

Raporti Financiar

NLB BANKA SH.A.

PASQYRAT FINANCIARE TË PËRGATITURA NË PËRPTHJE ME
STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR

PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019

ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR

PËRMBAJTJA	FAQE
DEKLARATA MBI PËRGJEGJËSITË E MENAXHMENTIT	3
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	4
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE	6
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	7
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	8
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	9
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE	10 - 80

DEKLARATA MBI PËRGJEGJËSITË E MENAXHMENTIT

Për aksionarët dhe bordin e drejtorëve të NLB Banka sh.a.

Bordi Udhëheqës konfirmon përgjegjësinë e tij për përgatitjen e pasqyrave financiare të Bankës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, dhe për politikat që shoqërojnë kontabilitetin dhe shënimet e pasqyrave financiare.


Bordi Udhëheqës është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për të dhënë një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozitës financiare të Bankës më 31 dhjetor 2019, rezultatet financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar.

Bordi Udhëheqës gjithashtu konfirmon se politikat e duhura kontabël janë aplikuar në mënyrë konsistente dhe se vlerësimet e kontabilitetit janë përgatitur në përputhje me parimet e kujdesit dhe menaxhimit të mirë. Bordi udhëheqës më tej konfirmon se pasqyrat financiare të Bankës, së bashku me shënimet shpjeguese, janë përgatitur në përputhje me parimin e vazhdueshmërisë së operimit të biznesit dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Bordi Udhëheqës është gjithashtu përgjegjës për praktikën e përshtatshme kontabël, për miratimin e masave të përshtatshme për ruajtjen e pasurive, dhe për parandalimin dhe identifikimin e mashtrimit dhe parregullsive të tjera ose aktiviteteve të paligjshme.


Prishtinë, Kosovë
4 mars 2020

Bordi Udhëheqës



Lavdim Koshutova

Anëtar i Bordit Udhëheqës



Gem Maloku

Anëtar i Bordit Udhëheqës



Albert Lumezi

Kryetar i Bordit Udhëheqës



**Building a better
working world**

Ernst & Young Certified
Auditors Ltd - Kosovo
Rr. Pashko Vasa 16/7
Prishtine, Kosova

Tel: +383 38 220 155
Fax: +383 38 220 155
ey.com

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionerët e NLB Banka Sh.a

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të NLB Banka Sh.a (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2019, dhe pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2019, dhe të rezultatit të saj financiar dhe rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA-të"). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarsisë) ("Kodi BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Bankës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë audituar nga një auditor tjetër i cili ka shprehur opinion pa rezervë më 26 shkurt 2019.

Informacione të tjera të përfshira në Raportin Vjetor të vitit 2019 të NLB Banka Sh.a.

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Bankës për vitin 2019, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të auditorit. Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Bankës për vitin 2019 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të auditorit.

Opinionit ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare (vijon)

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur menaxhmenti synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë.

Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA- të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencën auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e NLB Banka Sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k.

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k.

4 mars 2020

Prishtine, Kosovo

Mario Vangjeli
Auditor Ligjor





NLB BANKA SH.A.
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019


(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënim	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
PASURITË			
Paraja dhe gjendja me Bankën Qendrore	4	134,204	103,663
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	5	33,008	20,123
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	6	540,073	466,854
Pasuritë financiare sipas vlerës së drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	7	77,977	64,733
Pasuritë tjera	8	822	800
Prona pajisjet dhe e drejta e perdorimit të pasurive	9	13,721	10,870
Pasuritë e paprekshme	10	1,032	659
Tatimi i shtyrë	25	248	426
Gjithsej pasuritë		801,085	668,128
DETYRIMET			
Detyrimet ndaj bankave	11	594	392
Detyrimet ndaj klientëve	12	685,385	585,851
Detyrimet tjera financiare	13	8,194	3,697
Provizionet dhe detyrimet tjera	14	6,819	6,344
Garancionet në datën e emetimit regjistrohen me vlerën e drejtë e cila është e barabartë me shumën e pagesës së pranuar. Pagesa amortizohet në fitimin dhe humbjen gjatë periudhës së kontratës duke përdorur metodën lineare. Detyrimet e bankës sipas garancioneve më pas maten me:

- Matjen fillestare, amortizimi i zbritur i llogaritur për të regjistruar të ardhurat gjatë periudhës së garancionit;
- Vlerësimin më të mirë të shpenzimeve të nevojshme për të shlyer detyrimin.

2.23 Provizionet

Provizionet regjistrohen kur Banka ka një obligim të tanishëm ligjor ose konstruktiv, si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një qarkullim i burimeve që përmban përfitim ekonomike do të nevojitet që të zgjidhin detyrimin dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimeve. Provizionet maten me vlerësimin më të mirë të menaxhmentit për shpenzimet e nevojshme për të zgjidhur detyrimin në datën e pasqyrës së pozicionit financiar dhe zbriten në vlerën aktuale ku efekti është material.

2.24 Përfitimet e të punësuarve

Banka paguan kontribute për planin pensional të administruar publikisht (TKPK) në baza të obligueshme. Banka nuk ka detyrime tjera për pagesa pasi që kontributet të paguhen. Kontributet regjistrohen si shpenzime për përfitim të punësuarve atëherë kur ato duhet të paguhen.

2.25 Qiratë

i. Politika e zbatueshme para 1 janarit 2019

Përcaktimi nëse një aranzhim është me qira, ose përmban qiranë, bazohet në përmbajtjen e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një pasurie ose pasurish ose nëse marrëveshja përcjell një të drejtë për të përdorur pasurinë.

Banka si qiramarrëse

Qiratë që nuk transferojnë në thelb në Bankë të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rastësishme nga pronësia e gjërave të marra me qira janë qiratë operative. Pagesat e qirasë operative njihen si shpenzime në pasqyrën e të ardhurave mbi bazën lineare gjatë afatit të qirasë. Qiraja e pagueshme njihet si shpenzim në periudhën në të cilën ajo ndodh.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.25 Qiratë (vazhdim)

i. Politika e zbatueshme para 1 janarit 2019 (vazhdim)

Banka si qiradhënës

Qiratë kur Banka nuk transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjithë rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë klasifikohen si qira operative. Të ardhurat nga qiraja regjistrohen si të fituara bazuar në kushtet kontraktuale të qirasë në të ardhurat e tjera operative. Kostot e drejtpërdrejta fillestare të bëra në negociimin e qirave operative shtohen në vlerën kontabël të pasurisë të marrë me qira dhe njihen gjatë afatit të qirasë në të njëjtën bazë si të ardhurat nga qiraja. Qiratë njihen si të ardhura në periudhën në të cilën janë fituar. Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2018, Banka nuk ka realizuar asnjë kontratë si qiradhënëse.

ii. Politika e zbatueshme që nga 1 janari 2019

Banka vlerëson në fillim të kontratës nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Kjo do të thotë, nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një pasurie të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim për një konsideratë.

Banka si qiramarrëse

Banka aplikon një qasje të vetme njohjeje dhe matjeje për të gjitha qiratë, përveçse qirave afatshkurtra dhe qirave të pasurive me vlerë të ulët. Banka njih detyrimet e qirasë për të bërë pagesa qiraje dhe të së drejtës të përdorimit të pasurive që përfaqësojnë të drejtën e përdorimit të pasurive themelore.

E drejte e përdorimit të pasurive

Banka njih të drejtës e përdorimit të pasurisë në datën e fillimit të qirasë (d.m.th. data kur pasuria themelore është në dispozicion për përdorim). E drejta e përdorimit të pasurisë maten me kosto, duke zbritur çdo humbje të akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi, dhe rregullohen për çdo rivlerësim të detyrimeve të qirasë. Kostoja e pasurive të përdorimit të së drejtës përfshinë shumën e detyrimeve të qirave të njohura, kostot fillestare direkte të bëra, dhe pagesat e qirasë të bëra në ose para datës së fillimit, duke zbritur çdo stimulim të marrë me qira. E drejta e përdorimit të pasurisë zhvlerësohen në bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

E drejte e përdorimit të pasurive paraqitet ë Shënimin 9, Prona pajisjet dhe e drejta e përdorimit të pasurive.

Detyrimet e qirasë

Në datën e fillimit të qirasë, Banka njih detyrimet e qirasë të matura me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që do të bëhen gjatë afatit të qirasë. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesa fikse (duke zbritur çdo qira të arkëtueshme), pagesa të ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose një normë, dhe shumat që pritet të paguhën nën garancitë e vlerës së mbetur. Pagesat e qirasë përfshijnë gjithashtu çmimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje në mënyrë të arsyeshme që do të ushtrohet nga Banka dhe pagesa të gjobave për ndërprerjen e qirasë, nëse afati i qirasë reflekton ushtrimin e opsionit për të përfunduar. Pagesat e ndryshueshme të qirasë që nuk varen nga një indeks ose një normë njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ndodh ngjarja ose gjendja që shkakton pagesa.

Banka si qiradhënës

Qiradhëniet në të cilat Banka nuk transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rastësishme nga pronësia e një pasurie klasifikohen si qira operative. Të ardhurat nga qiraja që llogariten mbi bazën lineare mbi kushtet e qirasë dhe përfshihen në të ardhura në pasqyrën e të ardhurave ose humbjes për shkak të natyrës së saj operative. Kostot e drejtpërdrejta fillestare të bëra në negociimin dhe rregullimin e një qiraje operative i shtohen vlerës kontabël të pasurisë të marrë me qira dhe njihen gjatë afatit të qirasë në të njëjtën bazë si të ardhurat nga qiraja. Qiratë e kushtëzuara njihen si të ardhura në periudhën në të cilën janë fituar. Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2019, Banka nuk ka ndonjë kontratë si qiradhënëse.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.26 Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit

Në zbatimin e politikave të Bankës për kontabilitet, që përshkruhen në shënimin 2, menaxhmenti duhet të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime në lidhje me shumat e bartura të pasurive dhe detyrimeve të cilat nuk janë të qarta nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura janë të bazuara në përvojën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen të jenë të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në baza të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël regjistrohet në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar. Nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë, ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme, nëse rishikimi ndikon në të dyja periudhat aktuale dhe të ardhshme.

2.27 Rënia në vlerë e pasurive financiare

Matja e humbjeve nga rënia në vlerë sipas SNRF 9 në të gjitha kategoritë e pasurive financiare kërkon gjykimin, në veçanti, vlerësimin e shumës dhe kohës së rrjedhave monetare të ardhshme dhe vlerave të kolateralit gjatë përcaktimit të humbjeve nga rënia në vlerë dhe vlerësimit të një rritjeje të konsiderueshme në rrezikun kreditor. Këto vlerësime janë të nxitura nga një numër faktorësh, ndryshime në të cilat mund të rezultojë në nivele të ndryshme të lejimeve. Llogaritjet e HPK-së të bankës janë rezultatet e modeleve komplekse me një numër supozimesh themelore në lidhje me zgjedhjen e inputeve të ndryshueshme dhe ndërvarësive të tyre. Elementet e modeleve HPK që konsiderohen gjykime kontabël dhe vlerësime kontabël përfshijnë:

- Modeli i brendshëm i klasifikimit të kredive të Bankës, i cili i cakton PD për vlerësimet individuale
- Kriteret e Bankës për të vlerësuar nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në riskun kreditor dhe kështu lejimet për pasuritë financiare duhet të maten në bazë të LTECL dhe vlerësimit cilësor
- Segmentimi i pasurive financiare kur humbjet e tyre kreditore vlerësohet në baza kolektive
- Zhvillimi i modeleve të HPK-së, duke përfshirë formulat e ndryshme dhe zgjedhjen e inputeve
- Përcaktimi i lidhjeve mes skenarëve makroekonomikë dhe inputeve ekonomike, siç janë nivelet e papunësisë dhe vlerat e kolateralit, si dhe efektet në PD, EAD dhe LGD.
- Përzgjedhja e skenarëve makroekonomikë të parashikuar nga pikëpamjet dhe koeficientet e tyre të probabilitetit, për të nxjerrë inputet ekonomike në modelet e HPK-së, është politikë e Bankës që të rishikojë rregullisht modelet e saj në kontekstin e përvojës aktuale të humbjes dhe të rregullojë kur është e nevojshme.

2.28 Parimi i vijimësisë

Menaxhmenti i Bankës ka bërë një vlerësim të aftësisë së saj për të vazhduar biznesin dhe operacionet e saj dhe është i kënaqur që ka burime të mjaftueshme për të vazhduar biznesin e saj për të ardhmen e parashikueshme. Për më tepër, menaxhmenti nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e bankës për të vazhduar aktivitetin. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të jenë të përgatitura në bazë të parimit të vijimësisë.

2.29 Provizionet dhe detyrimet e tjera kontigjente

Banka operon në një mjedis të rregulluar dhe ligjor që nga natyra ka një element më të lartë të rrezikut gjyqësor, të qenësishme për operacionet e saj. Si rezultat, ai është i përfshirë në raste të ndryshme gjyqësore, arbitrazhi dhe rregullatorë si në Goodland ashtu edhe në juridiksione të tjera, që lindin në rrjedhën e zakonshme të biznesit të Bankës.

Kur Banka mund të matë rrjedhën e përfitimeve ekonomike në lidhje me një rast specifik dhe i konsideron daljet e tilla të mundshme, Banka regjistron një provizion kundër çështjes. Kur probabiliteti i rrjedhjes konsiderohet të jetë i largët, ose i mundshëm, por një vlerësim i besueshëm nuk mund të bëhet, një detyrim i kushtëzuar shpalolet. Sidoqoftë, kur Banka është e mendimit që publikimi i këtyre vlerësimeve rast pas rasti do të paragjykonte rezultatin e tyre, atëherë Banka nuk përfshin shpalosje të detajuar, specifike të rasteve në pasqyrat e saj financiare.

Duke pasur parasysh subjektivitetin dhe pasigurinë e përcaktimit të probabilitetit dhe sasisë së humbjeve, Banka merr në konsideratë një numër faktorësh përfshirë këshillat juridike, fazën e çështjes dhe provat historike nga incidente të ngjashme. Kërkohej gjykim i rëndësishëm për të dhënë vlerësime për keto çështje.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.30 Norma efektive e interesit

Siç është shpjeguar në Shënimin 2.5 të ardhurat dhe shpenzimet e të interesit janë njohur në fitim dhe humbje për të gjitha instrumentet që bartin interes në baza akruale duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat e vlerësuara të ardhshme monetare ose arkëtimet me anë të jetës së pritshme të instrumentit financiar. Norma efektive e interesit ndryshon nga norma e kontraktuar, si rezultat i taksave dhe komisionit që Banka mund të ketë ngarkuar, megjithatë, Banka nuk ka instrumente financiare ku pagesa shtesë dhe komisionet përfaqësojnë flukse të konsiderueshme të holla në krahasim me normën kontraktuale. Flukset e mjeteve monetare më të rëndësishme lindin nga tarifat që aplikohen në lëshimin e kreditë. Për shkak të kufizimeve të sistemit, Banka nuk përdor normën e interesit efektiv të njohë të ardhurat e përgjithshme të interesit nga kreditë, por shtyn tarifat e kreditimit veçmas mbi jetën e çdo kredie duke përdorur një metodë që përfaqëson normën e interesit efektiv dhe menaxhmenti e vlerëson se nuk ka dallime materiale.

2.31 Përcaktimi i afatit të qirasë për kontratat e qirasë me mundësi rinovimi dhe përfundimi (Banka si qiramarrëse)

Banka përcakton afatin e qirasë si afatin e paanulueshem, së bashku me çdo periudhë që mbulohet nga një mundësi për të zgjatur qiranë nëse është e sigurt që do të vazhdohet, ose nga ndonjë periudhë kohore e mbuluar nga një opsion për ndërprerjen e qirasë, nëse është me siguri të arsyeshme të mos vazhdohet.

Banka ka disa kontrata qiraje që përfshijnë mundësi zgjatjeje ose përfundimi të kontratave. Banka aplikon gjykimin e vet në vlerësimin nëse duhet të ushtrohet apo jo mundësia e rinovimit ose përfundimit të qirasë. Kjo do të thotë, i konsideron të gjithë faktorët e rëndësishëm që krijojnë një nxitje ekonomike që të bej rinovimin ose përfundimin. Pas datës së fillimit, Banka rivlerëson afatin e qirasë nëse ka një ngjarje të rëndësishme ose ndryshim në rrethanat që janë nën kontrollin e tij që ndikon për të ushtruar ose për të mos ushtruar mundësinë e rinovimit ose përfundimit (p.sh., ndërtimi apo rinovimi i ndonje pasurie).

2.32 Vlerësimi i normës rritëse të huamarrjes

Banka nuk mund të përcaktojë me lehtësi normën e interesit në qira, prandaj, përdor normën e saj rritëse të huamarrjes ("IBR") për të matur detyrimet e qirasë. IBR është norma e interesit që Banka do të duhet të paguante për të marrë hua për një afat të ngjashëm, dhe me një siguri të ngjashme, fondet e nevojshme për të marrë një pasuri të një vlere të ngjashme dhe të drejten e perdorimit në një ekonomi të ngjashme ekonomik. Shkalla e përdorur nga banka është 2.4% e cila paraqet normën e interesit në depozitat 5 vjeçare të klientëve. Prandaj, IBR pasqyron atë që Banka "duhet të paguante", e cila kërkon vlerësim kur nuk ka norma të vëzhgueshme (të tilla si për filialet që nuk hyjnë në transaksione të financimit) ose kur ato duhet të rregullohen për të pasqyruar kushtet e qirasë (për shembull, kur qiratë nuk janë në monedhën funksionale të filialit). Banka vlerëson IBR duke përdorur të dhëna të vëzhgueshme (të tilla si normat e interesit të tregut) kur janë në dispozicion dhe kërkohet të bëjë disa rregullime specifike të njësisë ekonomike (siç është vlerësimi kreditor i filialit, ose për të pasqyruar termat dhe kushtet e qirasë).

2.33 Tatimi

Shpenzimi aktual tatimor

Banka i nënshtrohet ligjeve tatimore në Republikën e Kosovës. Menaxhmenti përdor vlerësimin e tij më të mirë dhe gjykimin në përputhje të plotë me ligjet përkatëse tatimore. Për shkak të përdorimit të gjykimin në përputhje me kërkesat e caktuara të ligjeve tatimore dhe në varësi të vlerësimit të autoriteteve tatimore, detyrimet tatimore mund të ndryshojnë në krahasim me atë të raportuar në pasqyrat financiare, megjithatë, menaxhmenti është i bindur se nuk mund të lindin dallime materiale.

Tatimi i shtyrë i pasurive

Tatimi i shtyrë i pasurive njihet në lidhje me diferencat e përkohshme deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatuueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit humbjet mund të shfrytëzohen. Gjykimi është i nevojshëm për të përcaktuar shumën e pasurive të shtyra tatimore që mund të njihen, të bazuar mbi kohën, dhe nivelin e fitimit të tatuueshëm të ardhshëm, së bashku me strategjitë e ardhshme të taksave-planifikimit. Humbjet tatimore mund të përdoren për një periudhë prej 4 vjetësh në Kosovë.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.34 Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Kur vlerat e drejta të pasurive financiare dhe detyrimeve financiare të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të rrjedhin nga tregjet aktive, ato përcaktohen duke përdorur një shumëllojshmëri të teknikave të vlerësimit që përfshijnë përdorimin e modeleve matematikore. Banka në dispozicion për pasuritë financiare janë vetëm pasuritë e matura me vlerën e drejtë dhe ata nuk janë të rëndësishme për pasuritë financiare të përgjithshme. Për qëllim të publikimit të vlerës së drejtë të pasurive dhe detyrimeve të tjera financiare, modelet e vlerësimit janë përdorur e bazuar në të dhëna të vëzhgueshme të tregut ku është e mundur, por nëse kjo nuk është në dispozicion, gjykimi është i nevojshme për të krijuar vlerat e drejta. Shpalosja e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare dhe metodat e përdorura janë përshkruar më hollësisht në Shënimin 26.

2.35 Prezantimi i efekteve në kalimin në SNRF 16 që nga 1 janari 2019

Banka ka kontrata me qira për degë të ndryshme dhe pajisje IT. Para miratimit të SNRF 16, Banka e klasifikoi secilën prej qirave të saj (si qiramarrëse) në datën e fillimit si një qira financiare ose një qira operative. Pas miratimit të SNRF 16, Banka aplikoi një qasje të vetme njohjeje dhe matjeje për të gjitha qiradhëniet, përveç qirave afatshkurtra dhe qirave me vlerë të ulët. Standardi siguron kërkesa specifike të tranzicionit dhe ekspedita praktike, të cilat janë aplikuar nga Banka.

Qirate që më parë janë llogaritur si qira operative

Banka njohu drejtën e përdorimit të pasurisë dhe detyrimet e qirasë për ato qira të klasifikuara më parë si qira operative, me përjashtim të qirave afatshkurtra dhe qirave të pasurive me vlerë të ulët. E drejta e përdorimit të pasurisë për shumicën e qirave u njoh bazuar në vlerën kontabël sikur standardi të ishte zbatuar gjithnjë, përveç përdorimit të normës së huamarrjes shtesë në datën e aplikimit fillestar. Në disa qira, e drejta e përdorimit të pasurisë u njoh bazuar në shumën e barabartë me detyrimet e qirasë, rregulluar për çdo pagese të parapaguar dhe qirasë së njohur të njohur më parë. Detyrimet e qirasë u njohën bazuar në vlerën aktuale të pagesave të mbetura të qirasë, duke u zbritur dhe duke përdorur normën e huamarrjes shtesë në datën e aplikimit fillestar.

Banka gjithashtu aplikoi ekspedita praktike të disponueshme, në të cilat:

- Përdori një normë të vetme zbritje në një portofol të qirave me karakteristika të arsyeshme dhe të ngjashme
- U mbështet në vlerësimin e saj nëse qiratë janë të mëdha, menjëherë para datës së aplikimit fillestar
- Aplikoi përjashtimet e qirave afatshkurtra që përfundojnë brenda 12 muajve nga data e aplikimit fillestar
- Përjashtoi kostot fillestare direkte nga matja e drejtës së përdorimit të pasurisë në datën e aplikimit fillestar
- Vlersim i përdorur në përcaktimin e afatit të qirasë, ku kontrata përmban mundësi për të zgjatur ose përfunduar qiranë

Bazuar në të mësipërmet, që nga 1 janari 2019, ndikimi në pasqyrën e pozicionit financiar është si më poshtë:

- E drejte e përdorimit të pasurisë në vlerë prej 3 milion EUR u njoh dhe u prezantuan në pasqyrën e pozicionit financiar në "Prona Pajisjet dhe e Drejta e Përdorimit të Pasurisë".
- Detyrimet shtesë të qirasë prej 3 milion EUR (përfshirë në "Detyrimet e tjera") janë njohur.
- Miratimi i SNRF 16 nuk kishte asnjë ndikim në fitimet e mbajtura të Bankës dhe asnjë ndikim material në raportin e saj të mjaftueshmërisë së kapitalit.

3. ADAPTIMI I STANDARDEVE TE REJA OSE TE RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET E TYRE

i) Standardet dhe Interpretimet efektive në periudhën aktuale

Ndryshimet e reja në vijim të standardeve ekzistuese të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB) të cilat janë efektive për periudhën raportuese aktuale:

- **SNRF 16 "Qiratë"** - (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet në SNRF 9: Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ**, ndryshimet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive dhe janë efektive nga 1 janari 2019
- **Ndryshimet në SNK 28: Interesat afatgjata në shoqëri dhe sipërmarrje të përbashkëta**, duhet të aplikohen retrospektivisht dhe janë efektive nga 1 Janar 2019
- **Interpretimi i KIRFN 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat** – (Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019.),
- **Ndryshime në SNK 19: Plani i ndryshimit, mbylljes ose pageses**, efektiv për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019
- **IASB ka lëshuar Ciklin e Përmirësimeve Vjetore të SNRF-ve 2015 - 2017**, i cili është një përmbledhje e ndryshimeve në SNRF:
 - **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit dhe SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkët:**
 - **SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat:**
 - **SNK 23 Kostot e huamarrjes:**

ii) Standardet dhe interpretimet e lëshuara por ende jo efektive

Standardet dhe interpretimet që janë lëshuar, por ende jo efektive, deri në datën e lëshimit të pasqyrave financiare të Shoqërisë janë shpalosur më poshtë:

- **SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve** - (është efektiv për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021),
- **Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28: Shitja ose Kontributi i Pasurive ndërmjet një Investitori dhe Shoqërisë së tij ose Sipërmarrjes së Përbashkët** - (data efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar derisa projekti hulumtues mbi metodën e kapitalit të jetë përfunduar),
- **Ndryshimet në Referencat e Kornizës Konceptuale në Standardet e SNRF** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2020).
- **Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit"** - Përkufizimi i një biznesi (efektiv për kombinimet e biznesit për të cilin data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon në ose pas 1 Janarit 2020 dhe për blerjet e pasurive që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe).
- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet"** - Përkufizimi i materialit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2020),
- **Reforma e Standardit të Normës së Interesit - SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7 (Ndryshime)** - (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2020),
- **IAS 1 SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i Detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale (Ndryshimet)** - (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2020),

Banka ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datës së tyre të efektive. Banka parashikon që miratimi i këtyre standardeve, rishikimet dhe interpretimet nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës në periudhën e aplikimit fillestar.

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

4. PARAJA DHE GJENDJA ME BANKËN QENDRORE

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Paraja e gatshme	19,999	18,919
Paratë në banka – llogaritë rrjedhëse në bankat	32,652	14,917
<i>Shumat e mbajtura në BQK</i>	-	-
Llogaria rrjedhëse	26,972	23,595
Llogaria rezervë statutore	54,690	46,323
Humbjet nga provizionimet	(109)	(91)
Paraja dhe gjendja me Bankën Qendrore	134,204	103,663

Lëvizja në provizion për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2019 dhe 2018, ngarkuar në fitim dhe humbje është si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Gjendja fillestare	91	-
Efekti i transferit në SNRF 9	-	122
Ngarkuar në fitim dhe humbje	18	(31)
Gjendja mbyllëse	109	91

Gjatë vitit 2019 shumica e bankave korrospodente kanë aplikuar norma negative të interesit mbi kufij të caktuar. Normat ndryshonin nga -0.40% deri në 0.75% për Euro kurse për valutat tjera nga -0.75% deri në 2.0%.

Për shkak të transformimit të depozitave të klientëve duke rritur detyrimet me afat maturimi deri në një vit, kërkesa për bazë të rezervës minimale është rritur gjatë vitit 2019 për 8 milionë euro.

Pasuritë likuide të kualitetit të lartë u rritën gjatë vitit, kryesisht për shkak të rritjes së parasë së gatshme në arkë dhe balancave me Bankën Qendrore.

Bilanci dhe rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore të Kosovës ("BQK") përfaqëson rezervën e detyrueshme sipas rregulloreve të BQK-së siç diskutohet në shënimin 2.11. Rezerva statutore nuk është e disponueshme për përdorim ditor nga banka. Bilanci i kufizuar i rezervave të likuiditetit me BQK-në përjashtohet nga paraja dhe ekuivalentët e mjeteve monetare për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë. Banka Qendrore e Kosovës nuk posedon vlerësim të jashtëm kreditor.

4.1 PARAJA DHE GJENDJA ME BANKËN QENDRORE

Paraja dhe ekuivalentet e saj në pasqyrën e rrjedhës të parasë përbëhen nga:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Paraja e gatshme dhe gjendja në Bankën Qendrore	134,204	103,663
Minus: Rezerva e likuiditetit	(27,345)	(23,162)
Depozitat me maturim më pak se 3 muaj (shënimi 5)	28,732	15,196
Paraja dhe ekuivalentët e saj	135,591	95,697

NLB BANKA SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

4. PARAJA DHE GJENDJA ME BANKËN QENDRORE (VAZHDIM)

Lëvizja në provizionin e rënies në vlerë të parave dhe gjendjes me Bankën Qendrore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, bazuar në kërkesat e SNRF 9, është si vijon:

	Gjendja më 1 janar 2019	Transferet	Rritja / (Zvogëlim)	Shlyerjet	Pagesat e te arketushmeve të shlyera	Ndryshimi në parametrat e modelit të riskut	Këmbimet valutore dhe lëvizjet e tjera	Gjendja më 31 dhjetor 2019
31 dhjetor 2019								
Faza 1 12 M humbjet e pritshme kreditore	(91)	-	(26)	-	-	8	-	(109)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	(91)	-	(26)			8	-	(109)
Faza 2 - humbjet e pritshme kreditore jo të rëna në vlerë	-	-	-	-	-	-	-	-
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	-	-					-	-
Faza 3 - humbjet e pritshme kreditore të rëna në vlerë	-	-	-	-	-	-	-	-
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	-	-					-	-
Gjithsej	(91)	-	(26)	-	-	8	-	(109)

	Gjendja më 1 janar 2018	Transferet	Rritja / (Zvogëlim)	Shlyerjet	Pagesat e te arketushmeve të shlyera	Ndryshimi në parametrat e rrezikut të modelit	Këmbimet valutore dhe lëvizjet e tjera	Gjendja më 31 dhjetor 2019
31 dhjetor 2018								
Faza 1 12 M humbjet e pritshme kreditore	(132)	-	41	-	-	-	-	(91)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	(132)	-	41			-	-	(91)
Faza 2 - humbjet e pritshme kreditore jo të rëna në vlerë	-	-	-	-	-	-	-	-
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	-	-					-	-
Faza 3 - humbjet e pritshme kreditore të rëna në vlerë	-	-	-	-	-	-	-	-
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	-	-					-	-
Gjithsej	(132)	-	41	-	-	-	-	(91)

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR BANKAT

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Depozitat e afatizuar me maturim më pak se tre muaj	28,732	15,186
Depozitat e afatizuar	4,292	4,994
Interesi i përlogaritur	(10)	2
Lejimet për provizionet	(6)	(69)
Gjithsej kreditë dhe paradhënjet ndaj bankave	33,008	20,123
Afatshkurtër	33,008	20,123

Më 31 dhjetor 2019, në depozitat me afat të përgjithshëm, janë 4,294 mijë euro, të cilat janë fonde të bllokuara për aktivitetet e financimit të tregtisë (2018: 4,494 mijë euro).

Lëvizja e provizionit për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është si vijon:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Gjendja fillestare	69	-
Efekti i transferit në SNRF 9	-	61
Ngarkuar në fitim dhe humbje	(63)	8
Gjendja përfundimtare	6	69

NLB BANKA SH.A.

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR BANKAT (VAZHDIM)

Lëvizja në provizionin e rënies në vlerë të parave dhe gjendjes me Bankën Qendrore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, bazuar në kërkesat e SNRF 9:

31 Dhjetor 2019	Gjendja më 1 janar 2019	Transferet	Rritja / (Zvogëlim)	Shlyerjet	Pagesat e të arketushmeve të shlyera	Ndryshimi në parametrat e rrezikut të modelit	Këmbimet valutore dhe lëvizjet e tjera	Gjendja më 31 dhjetor 2019
Faza 1 12 M humbjet e pritshme kreditore	(69)	-	59	-	-	4	-	(6)
Plasmanet	(69)	-	59	-	-	4	-	(6)
Faza 2 - humbjet e pritshme kreditore jo të rëna ne vlerë	-	-	-	-	-	-	-	-
Plasmanet	-	-	-	-	-	-	-	-
Faza 3 - humbjet e pritshme kreditore të rëna ne vlerë	-	-	-	-	-	-	-	-
Plasmanet	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	(69)	-	59	-	-	4	-	(6)

31 Dhjetor 2018	Gjendja më 1 janar 2018	Transferet	Rritja / (Zvogëlim)	Shlyerjet	Pagesat e të arketushmeve të shlyera	Ndryshimi në parametrat e rrezikut të modelit	Këmbimet valutore dhe lëvizjet e tjera	Gjendja më 31 dhjetor 2018
Faza 1 12 M humbjet e pritshme kreditore	(61)	-	(8)	-	-	-	-	(69)
Plasmanet	(61)	-	(8)	-	-	-	-	(69)
Faza 2 - humbjet e pritshme kreditore jo të rëna ne vlere	-	-	-	-	-	-	-	-
Plasmanet	-	-	-	-	-	-	-	-
Faza 3 - humbjet e pritshme kreditore të rëna ne vlere	-	-	-	-	-	-	-	-
Plasmanet	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	(61)	-	(8)	-	-	-	-	(69)

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTËT

Analiza sipas klasave

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Kreditë e klientëve	472,243	406,129
Mbitërheqjet	89,124	82,522
Kreditë kartelat	5,736	5,299
	567,103	493,950
Provizionet për zhvlerësim të kredive të klientëve	(27,030)	(27,096)
Gjithsej kreditë e klientëve	540,073	466,854
Afatshkurtëra	190,706	169,089
Afatgjatë	349,367	297,765

Kreditë dhe paradhëniet për klientët përfshijnë interesin e përlogaritur në të ardhurat në shumën 1,494 mijë euro (31 dhjetor 2018: 1,670 mijë euro). Kreditë dhe paradhëniet për klientët përfshijnë edhe tarifën e disbursimit të shtyrë që është pjesë e normës efektive të interesit nga kreditë për klientët në shumën prej 1,580 mijë euro (2018: 1,290 mijë euro). Mbitërheqjet paraqesin produkte afatshkurtër revolving dhe kredi konsumuese.

Klasifikimi në afatshkurtër dhe afatgjatë është bërë në baza kontraktuale.

Analiza sipas sektorëve është siç vijon:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Vlera kontabël bruto		
Klientët korporata	359,414	315,408
Klientët individualë	207,689	178,542
	567,103	493,950
Minus: Provizioni për rënie në vlerë		
Klientët korporata	(24,083)	(23,208)
Klientët individualë	(2,947)	(3,888)
	(27,030)	(27,096)

Tabela më poshtë tregon cilësinë e kredisë dhe ekspozimin maksimal ndaj huave dhe paradhënieve ndaj klientëve bazuar në sistemin e vlerësimit kreditor të brendshëm të Bankës, intervalin 12 muaj të Bazelit III PD dhe klasifikimin e fazës fundvitit. Shumat e paraqitura janë provizionet bruto të rënies në vlerë.

31 dhjetor 2019

Shkalla e vlerësimit të brendshëm	12 muaj Basel III PD klasifikimi	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Gjithsej
Performuese						
Shkëlqyeshëm	0.27% - 5.24%	267,155	9	-	-	267,164
Mirë	5.24% - 12.40%	195,714	33,189	-	-	228,903
Kënaqshëm	12.40% - 20.12%	1,988	58,109	-	-	60,097
Rëndomtë	100.00%	-	-	3,696	-	3,696
Jo performuese						
Te rëna në vlerë individualisht	100.00%	-	-	7,243	-	7,243
Gjithsej		464,857	91,307	10,939	-	567,103

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTËT (VAZHDIM)

31 dhjetor 2018

Shkalla e vlerësimit të brendshëm	12 muaj Basel III PD klasifikimi	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Gjithsej
Performuese						
Shkëlqyeshëm	0.48% - 5.65%	228,871	13	-	-	228,884
Mirë	5.65% - 18.43%	94,414	59,039	-	-	153,453
Kënaqshëm	18.43% - 26.95%	3,393	93,859	-	-	97,252
Rëndomtë	100.00%	-	-	5,358	-	5,358
Jo performuese						
Te rëna në vlerë individualisht	100.00%	-	-	9,003	-	9,003
Gjithsej		326,678	152,911	14,361	-	493,950

Tabela më poshtë tregon cilësinë e kredisë dhe ekspozimin maksimal ndaj huave dhe paradhënieve ndaj klientëve në nivelin e segmentit më 31 dhjetor 2019.

Kreditë për korporata

Shkalla e vlerësimit të brendshëm	12 muaj Basel III PD klasifikimi	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Gjithsej
Performuese						
Shkëlqyeshëm	0.27% - 5.24%	69,913	-	-	-	69,913
Mirë	5.24% - 12.40%	193,596	32,990	-	-	226,586
Kënaqshëm	12.40% - 20.12%	1,459	51,710	-	-	53,169
Rëndomtë	100.00%	-	-	3,147	-	3,147
Jo performuese						
Te rëna në vlerë individualisht	100.00%	-	-	6,599	-	6,599
Gjithsej		264,968	84,700	9,746	-	359,414

Kreditë për Individualë

Shkalla e vlerësimit të brendshëm	12 muaj Basel III PD klasifikimi	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Gjithsej
Performuese						
Shkëlqyeshëm	0.27% - 5.24%	197,242	9	-	-	197,251
Mirë	5.24% - 12.40%	2,118	199	-	-	2,317
Kënaqshëm	12.40% - 20.12%	529	6,399	-	-	6,928
Rëndomtë	100.00%	-	-	549	-	549
Jo performuese						
Te rëna në vlerë individualisht	100.00%	-	-	644	-	644
Gjithsej		199,889	6,607	1,193	-	207,689

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTËT (VAZHDIM)

Tabela më poshtë tregon cilësinë e kredisë dhe ekspozimin maksimal ndaj huave dhe paradhënies të klientëve në nivelin e segmentit më 31 dhjetor 2018.

Kreditë për korporata

Shkalla e vlerësimit të brendshëm	12 muaj Basel III PD klasifikimi	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Gjithsej
Performuese						
Shkëlqyeshëm	0.48% - 5.65%	62,857	6	-	-	62,863
Mirë	5.65% - 18.43%	92,593	58,759	-	-	151,352
Kënaqshëm	18.43% - 26.95%	3,148	84,903	-	-	88,051
Rëndomtë	100.00%	-	-	4,637	-	4,637
Jo performuese						
Te rëna në vlerë individualisht	100.00%	-	-	8,505	-	8,505
Gjithsej		158,598	143,668	13,142	-	315,408

Kreditë për Individualë

Shkalla e vlerësimit të brendshëm	12 muaj Basel III PD klasifikimi	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Gjithsej
Performuese						
Shkëlqyeshëm	0.48% - 5.65%	166,014	7	-	-	166,021
Mirë	5.65% - 18.43%	1,821	280	-	-	2,101
Kënaqshëm	18.43% - 26.95%	245	8,956	-	-	9,201
Rëndomtë	100.00%	-	-	721	-	721
Jo performuese						
Te rëna në vlerë individualisht	100.00%	-	-	498	-	498
Gjithsej		168,080	9,243	1,219	-	178,542

Tabelat më poshtë përmbledhin vjetërsinë e fazës 2 dhe fazës 3, më 31 dhjetor 2019:

31 dhjetor 2019	Faza 2		Faza 3		Gjithsej	
	Vlera bartëse bruto	ECL	Vlera bartëse bruto uto	ECL	Vlera bartëse bruto	ECL
Më pak se:	5,453	356	5,228	4,720	10,681	5,076
30 ditë vonesë	5,453	356	653	577	6,106	933
90 ditë vonesë	-	-	4,575	4,143	4,575	4,143
Me shume se:	1,005	57	2,702	2,564	3,707	2,621
30 ditë vonesë	1,005	57	-	-	1,005	57
90 ditë vonesë	-	-	2,702	2,564	2,702	2,564
Gjithsej	6,458	413	7,930	7,284	14,388	7,697

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTËT (VAZHDIM)

Tabelat më poshtë përmbledhin vjetersine e fazës 2 dhe fazës 3, më 31 dhjetor 2019 per klientët korporata:

Kreditë për korporata	Faza 2		Faza 3		Gjithsej	
	Vlera bartëse bruto	ECL	Vlera bartëse bruto	ECL	Vlera bartëse bruto	ECL
31 Dhjetor, 2019						
Më pak se:	5,100	288	4,801	4,429	9,901	4,717
30 ditë vonesë	5,100	288	419	415	5,519	703
90 ditë vonesë	-	-	4,382	4,014	4,382	4,014
Me shume se:	766	25	2,201	2,098	2,967	2,123
30 ditë vonesë	766	25	-	-	766	25
90 ditë vonesë	-	-	2,201	2,098	2,201	2,098
Gjithsej	5,866	313	7,002	6,527	12,868	6,840

Tabelat më poshtë përmbledhin vjetersine e fazës 2 dhe fazës 3, më 31 dhjetor 2019 per klientët individualë:

Kreditë për Individualë	Faza 2		Faza 3		Gjithsej	
	Vlera bartëse bruto	ECL	Vlera bartëse bruto	ECL	Vlera bartëse bruto	ECL
31 Dhjetor, 2019						
Më pak se:	353	68	427	291	780	359
30 ditë vonesë	353	68	234	162	587	230
90 ditë vonesë	-	-	193	129	193	129
Me shume se:	239	32	501	466	740	498
30 ditë vonesë	239	32	-	-	239	32
90 ditë vonesë	-	-	501	466	501	466
Gjithsej	592	100	928	757	1,520	857

Tabelat më poshtë përmbledhin vjetersine e fazës 2 dhe fazës 3, më 31 dhjetor 2018:

31 dhjetor 2018	Faza 2		Faza 3		Gjithsej	
	Vlera bartëse bruto	ECL	Vlera bartëse bruto	ECL	Vlera bartëse bruto	ECL
Më pak se:	4,715	350	4,487	4,176	9,201	4,526
30 ditë vonesë	4,715	350	3,422	3,340	8,136	3,690
90 ditë vonesë	-	-	1,065	836	1,065	836
Me shume se:	892	80	5,486	5,289	6,378	5,369
30 ditë vonesë	855	80	-	-	855	80
90 ditë vonesë	37	-	5,486	5,289	5,523	5,289
Gjithsej	5,607	430	9,973	9,465	15,579	9,895

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTËT (VAZHDIM)

Tabelat më poshtë përmbledhin vjetersine e fazës 2 dhe fazës 3, më 31 dhjetor 2018 per klientët korporata:

Kreditë për korporata	Faza 2		Faza 3		Gjithsej	
	Vlera bartëse bruto	ECL	Vlera bartëse bruto	ECL	Vlera bartëse bruto	ECL
31 dhjetor 2018						
Më pak se:	4,229	219	4,100	3,904	8,329	4,123
30 ditë vonesë	4,229	219	3,247	3,233	7,476	3,452
90 ditë vonesë	-	-	853	671	853	671
Me shume se:	560	34	4,917	4,797	5,477	4,831
30 ditë vonesë	523	34	-	-	523	34
90 ditë vonesë	37	-	4,917	4,797	4,954	4,797
Gjithsej	4,789	253	9,017	8,701	13,806	8,954

Tabelat më poshtë përmbledhin vjetersine e fazës 2 dhe fazës 3, më 31 dhjetor 2018 për klientët individual:

Kreditë për Individualë	Faza 2		Faza 3		Gjithsej	
	Vlera bartëse bruto	ECL	Vlera bartëse bruto	ECL	Vlera bartëse bruto	ECL
31 Dhjetor, 2018						
Më pak se:	486	131	387	272	872	403
Më pak se:	486	131	175	107	660	238
30 ditë vonesë	-	-	212	165	212	165
90 ditë vonesë	332	46	569	492	901	538
Me shume se:	332	46	-	-	332	46
30 ditë vonesë	-	-	569	492	569	492
Gjithsej	818	177	956	764	1,773	941

Lejimet për rënie në vlerë për kreditë dhe paradheniet për klientet - Shpenzimi në fitim ose humbje

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzimi i rënies në vlerë për vitin	2,909	4,708
Rikthimi i kredive të siguruara plotësisht	(534)	(608)
Shpenzimi në fitim ose humbje	2,375	4,100

Lëvizjet për lejimet e rënies në vlerë për kreditë dhe paradheniet per klientët

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Provizioni për rëniet në vlerë të kredive më 1 janar,	27,096	27,468
Efekti i transferimit në SNRF 9	-	(3,442)
Shpenzimi gjatë vitit	20,604	12,558
Rikthimet	(17,695)	(7,872)
Kreditë e shlyera	(2,975)	(1,616)
Provizioni për rënien ne vlerë të kredive me 31 dhjetor	27,030	27,096

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTËT (VAZHDIM)

Lëvizja në provizionin e rënies në vlerë për kreditë dhe paradhëniet për klientët për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, bazuar në kërkesat e SNRF 9, është si vijon:

	Gjendja më 1 janar 2019	Transferet	Rritja / (Zvogëlim)	Shlyerjet	Pagesat e te arketushmeve të shlyera	Ndryshimi në parametret e rrezikut të modelit	Këmbimet valutore dhe lëvizjet e tjera	Gjendja më 31 dhjetor 2019
31 dhjetor 2019								
Faza 1 12 M humbjet e pritshme kreditore	(3,857)	(1,186)	(3,344)	-	-	529	-	(7,858)
Kreditë dhe paradhëniet për individët	(451)	(177)	(223)	-	-	53	-	(798)
Kreditë dhe paradhëniet për personat juridikë	(3,406)	(1,009)	(3,121)	-	-	476	-	(7,060)
Faza 2 - humbjet e pritshme kreditore jo të rëna në vlerë	(10,459)	(140)	1,379	-	-	(548)	-	(9,768)
Kreditë dhe paradhëniet për individët	(2,556)	(59)	1,100	-	-	248	-	(1,267)
Kreditë dhe paradhëniet për personat juridikë	(7,903)	(81)	279	-	-	(796)	-	(8,501)
Faza 3 - humbjet e pritshme kreditore të rëna në vlerë	(12,780)	1,326	(367)	2,975	(554)	(4)	-	(9,404)
Kreditë dhe paradhëniet për individët	(882)	235	(286)	149	(134)	34	-	(884)
Kreditë dhe paradhëniet për personat juridikë	(11,898)	1,091	(81)	2,826	(420)	(38)	-	(8,520)
Gjithsej	(27,096)	-	(2,332)	2,975	(554)	(23)	-	(27,030)

6. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTËT (VAZHDIM)

Lëvizja në provizionin e rënies në vlerë për kreditë dhe paradhëniet për klientët për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018, bazuar në kërkesat e SNRF 9, është si vijon:

31 dhjetor 2018	Gjendja më 1 janar 2018	Transferet	Rritja / (Zvogëlim)	Shlyerjet	Pagesat e te arketushmeve te shlyera	Ndryshimi në parametrat e rrezikut të modelit	Këmbimet valutore dhe lëvizjet e tjera	Gjendja më 31 dhjetor 2018
Faza 1 12 M humbjet e pritshme kreditore	(760)	(1,964)	(1,844)	-	-	711	-	(3,857)
Kreditë dhe paradhëniet për individët	(581)	(2,213)	2,153	-	-	190	-	(451)
Kreditë dhe paradhëniet për personat juridikë	(179)	249	(3,997)	-	-	521	-	(3,406)
Faza 2 - humbjet e pritshme kreditore jo të rëna ne vlerë	(10,630)	(678)	(208)	-	-	1,057	-	(10,459)
Kreditë dhe paradhëniet për individët	(152)	1,831	(4,257)	-	-	22	-	(2,556)
Kreditë dhe paradhëniet për personat juridikë	(10,478)	(2,509)	4,049	-	-	1,035	-	(7,903)
Faza 3 - humbjet e pritshme kreditore të rëna ne vlerë	(12,636)	2,642	(3,794)	1,616	(608)	-	-	(12,780)
Kreditë dhe paradhëniet për individët	(772)	2,259	(2,293)	119	(195)	-	-	(882)
Kreditë dhe paradhëniet për personat juridikë	(11,864)	383	(1,501)	1,497	(413)	-	-	(11,898)
Gjithsej	(24,026)	-	(5,846)	1,616	(608)	1,768	-	(27,096)

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

7. PASURITË FINANCIARE SIPAS VLERËS SË DREJTË PËRMES TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Bono thesari dhe obligacione	77,312	64,278
Investimet në aksione	665	455
Gjithsej pasuritë financiare në vlerë të drejtë përmes të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse	77,977	64,733
Afatshkurtëra	21,147	44,862
Afatgjata	56,830	19,871

Letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës arritën në 70.3 milionë euro dhe krahasuar me 31.12.2018 ato u ulën me 7.6 milionë euro ose 12.2%. Struktura e letrave me vlerë është si vijon:

- Obligacionet e Kosovës janë 66.3 milionë euro, (normat e interesit 0.7% deri 3.2%) dhe maturimi 3-6.5 vjet.
- Bonot e Thesarit të Kosovës 4 milionë euro, (normat e interesit 0.68%) dhe maturimi 1 vit.
- Bono amerikane 7.1 milionë, (norma e interesit prej 2.47%) dhe maturimi 7 muaj.

Të gjitha pasuritë financiare të gatshme për shitje janë me interes fikse. Deri më 31 dhjetor 2019 nuk ka letra me vlerë të borxhit ndaj palëve të treta.

Investimi në aksione përfaqësojnë shumën prej 0.7 milion në VISA Inc, Klasa C Stoque të zakonshme, të kuotuar në tregun aktiv. Këto instrumente të kapitalit neto janë dhënë nga VISA inc për të gjithë anëtarët e saj pa asnjë konsideratë. Vlera e drejtë e instrumenteve në datën e dhënies është njohur nga Banka në të ardhurat e vitit aktual.

Tabela më poshtë tregon cilësinë e kredisë dhe ekspozimin maksimal për pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si:

31 dhjetor 2019

Shkalla e vlerësimit të brendshëm	12 muaj Basel III PD klasifikimi	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Gjithsej
Performuese						
Shkëlqyeshëm	0.27% - 5.24%	7,837	-	-	-	7,837
Mirë	5.24% - 12.40%	70,140	-	-	-	70,140
Kënaqshëm	12.40% - 20.12%	-	-	-	-	-
Rëndomtë	100.00%	-	-	-	-	-
Jo performuese						
Te rëna në vlerë	100.00%	-	-	-	-	-
Gjithsej		77,977	-	-	-	77,977

31 dhjetor 2018

Shkalla e vlerësimit të brendshëm	12 muaj Basel III PD klasifikimi	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Gjithsej
Kryerja						
Shkëlqyeshëm	0.48% - 5.65%	2,190	-	-	-	2,190
Mirë	5.65% - 18.43%	4,221	-	-	-	4,221
Kënaqshëm	18.43% - 26.95%	58,321	-	-	-	58,322
Rëndomtë	100.00%	-	-	-	-	-
Jo performuese						
Te rëna në vlerë	100.00%	-	-	-	-	-
Gjithsej		64,733	-	-	-	64,733

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

7. PASURITË FINANCIARE SIPAS VLERËS SË DREJTË PËRMES TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE (VAZHDIM)

Lëvizja në rënien në vlerë për instrumentet financiare në vlerë të drejtë ngarkuar me fitimin dhe humbjen dhe kapitalin është si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Gjendja fillestare	539	-
Efekti i transferit ne IFRS 9	-	874
Ngarkuar në fitim dhe humbje	307	(335)
Gjendja perfundimtare	846	539

Letrat me vlerë të borxhit:	Gjendja më		Rritja / (Zvogëlim)	Shlyerjet	Pagesat e te arketushmeve te shlyera	Ndryshimi në parametrat e rrezikut të modelit	Këmbimet valutore dhe lëvizjet e tjera	Gjendja më 31 dhjetor 2019
	31 dhjetor 2019	1 janar 2019						
Faza 1 12 M humbjet e pritshme kreditore	(539)	-	(473)	-	-	166	-	(846)
Faza 2 - humbjet e pritshme kreditore jo të rëna ne vlerë	-	-	-	-	-	-	-	-
Faza 3 - humbjet e pritshme kreditore të rëna ne vlerë	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	(539)	-	(473)	-	-	166	-	(846)

Letrat me vlerë të borxhit:	Gjendja më		Rritja / (Zvogëlim)	Shlyerjet	Pagesat e te arketushmeve te shlyera	Ndryshimi në parametrat e rrezikut të modelit	Këmbimet valutore dhe lëvizjet e tjera	Gjendja më 31 dhjetor 2018
	31 dhjetor 2018	1 janar 2018						
Faza 1 12 M humbjet e pritshme kreditore	(874)	-	335	-	-	-	-	(539)
Letrat me vlerë të borxhit:	(874)	-	335	-	-	-	-	(539)
Faza 2 - humbjet e pritshme kreditore jo të rëna ne vlerë	-	-	-	-	-	-	-	-
Faza 3 - humbjet e pritshme kreditore të rëna ne vlerë	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	(874)	-	335	-	-	-	-	(539)

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

8. PASURITË TJERA

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime të parapaguara	346	341
Kolaterali i konfiskuar në kreditë e pariparueshme	-	32
Inventari	16	18
Pasuritë e tjera financiare	460	409
Gjithsej pasuritë tjera	822	800
Afatshkurtëra	822	800

Kolaterali i konfiskuar i huave të pariparueshme në vitin 2019 përbëhet nga pasuri të paluajtshme dhe pajisje me vlerë bruto prej 132 mijë eurosh, të siguruara plotësisht nga Banka. Pasuritë e tjera financiare përbëhen nga të arkëtueshme nga mirëmbajtja e llogarive, arkëtimet nga kompanitë e sigurimeve etj, dhe humbjet e pritura kreditore të tyre janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019			31 dhjetor 2018		
	Shuma bruto	Rënia në vlerë	Shuma neto	Shuma bruto	Rënia në vlerë	Shuma neto
Pasuritë tjera financiare	778	(318)	460	1,464	(1,055)	409
Gjithsej	778	(318)	460	1,464	(1,055)	409

Lëvizja e rënies në vlerë për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është si vijon:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Gjendja fillestare	1,055	1,068
Transferimi në SNRF 9	-	(13)
Kthimet	(737)	-
Ngarkuar në fitim dhe humbje	-	-
Gjendja perfundimtare	318	1,055

Kthimet e provizioneve janë tërësisht si rezultat i zvogëlimit të balancave të tjera të pasurive financiare si rezultat i mbledhjeve ose realizimeve.

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

9. PRONA PAJISJET DHE E DREJTA E PËRDORIMIT TË PASURISË

	Ndërtesat	Investime në objektet me qira	Mobiljet dhe pajisjet	Kompjuterët dhe pajisjet	Veturat motorike	E drejta e përdorimit të pasurive	Gjithsej
Kostoja:							
Gap analizat janë të lidhura me teknikën e matjes së riskut të normës kamatore, duke përcaktuar kështu se cili mjet, detyrim apo mjet jashtëbilancorë kategorizohen në periudha korrespondente me ri-çmimin paraprak kontraktues (për instrumentet me normë kamatore lëkundëse) apo datë maturimi (për instrumentet me normë kamatore fikse.

Mjetet dhe detyrimet pa datë maturimi (p.sh. depozitat me kërkesë) apo me datë maturimi të cilat mund të jenë ndryshe nga datat origjinale të maturimit të përcaktuara me kontrata janë të kategorizuara në periudha korrespondente kohore bazuar në vlerësimin e bankës dhe duke pasur parasysh përvojën paraprake.

Me qëllim të menaxhimit më adekuat të riskut ndaj normave kamatore dhe matjes, metodologjia BPV (Basis Point Value) përdoret për matjen e Instrumenteve financiare' ndjeshmëria ndaj ndryshimeve të normave kamatore të tregut. Bazuar në këtë metodë, vlerësohet se si vlera e pozicionit ndryshohet nëse ndryshohen edhe normat kamatore të tregut me +/- 200 pika bazike.

Instrument kryesor për menaxhimin e ekspozimit të normave kamatore janë gap analizat, p.sh.. gap analizat për mjetet dhe detyrimet që bartin interes. Këshilli për Menaxhimin e Pasurive dhe Detyrimeve (ALCO) bazuar më propozimin e shërbimeve eksperte, adapton strategjinë për rregullimin e zërave në pjesën e aktivës dhe pasivës bazuar në ndryshimet e supozuara në normat kamatore të tregut.

Analizat e ndjeshmërisë

Menaxhimi i riskut të normës të interesit plotësohet me anë të monitorimit të ndjeshmërisë së fitimit të Bankës apo humbjes dhe kapitalit ndaj skenarëve të normave të luhatshme të interesit. Analizat e ndjeshmërisë ndaj normave të interesit janë përcaktuar bazuar në ekspozimin e riskut të normës kamatore në datën raportuese. Sipas analizave supozohet një rritje paralele e normave kamatore prej 200 pika bazike ($\pm 2\%$) në nivel të neto fitimit dhe ekuitetit.

Ekspozimi ndaj riskut të normave kamatore dhe ndikimi i tij në pasyrën e bankës mbi ndryshimet në ekuitet dhe në fitim e humbje matet përmes metodologjisë së Vlerave të Pikave Bazike. Rezultatet e paraqitura më poshtë paraqesin ndryshimet në fitimin dhe humbjen dhe ekuitetin, e cila do të ndodhte nëse normat kamatore do të rriteshin apo zvogëloheshin për 200 pika bazike.

Analizat e ndjeshmërisë së fitimit dhe humbjes dhe ekuitetit ndaj ndryshimeve në norma kamatore janë si në vijim:

	Ndjeshmëria e fitimit, humbjes dhe ekuitetit	
	2019	2018
Ndjeshmëria e normave të interesit		
Rritje në pikat bazike		
+200 bps zhvendosje paralele	(5,517)	(2,112)
	Ndjeshmëria e fitimit dhe humbjes	
	2019	2018
Zbritje në pikat bazike		
-200 bps zhvendosje paralele	3,179	6,476

Rezultati i Basis Point Value (BPV) më 31 dhjetor 2019 është -7.23% e kapitalit (2018: -8.6%). Sipas politikës së administrimit të rrezikut të normës së interesit kufiri maksimal i BPV rezultat është -12% të kapitalit të përgjithshëm.

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

30. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

f. Risku i normës së interesit (vazhdim)

Tabela më poshtë jep pozitën e normës neto të interesit për pasuritë financiare dhe detyrimet financiare të monitoruara nga menaxhmenti.

31 dhjetor 2019	Që bartin interes	1 muaj	Prej 1 - 3 muaj	Prej 3 muaj - 1 vit	Prej 1 - 5 vite	Mbi 5 vite	Që nuk bartin interes
Pasuritë financiare							
Paraja dhe balanca me Bankën Qendrore	134,204	59,515	-	-	-	-	74,689
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	33,008	21,221	8,561	2,143	1,083	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët, neto	540,073	16,610	32,138	141,958	258,744	90,623	-
Pasuritë financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	77,977	5,802	6,238	9,145	55,061	1,731	-
Pasuritë e përgjithshme financiare	785,262	103,148	46,937	153,246	314,888	92,354	74,689
Detyrimet							
Detyrimet ndaj bankave	594	-	-	-	-	-	594
Detyrimet ndaj klientëve	685,385	3,255	10,985	72,964	100,318	-	497,863
Borxhet dhe huazimet tjera	15,048	11	4	16	17	15,000	-
Gjithsej detyrimet financiare	701,027	3,266	10,989	72,980	100,335	15,000	498,457
Gjithsej hendeku i rivlerësimit të interesit		99,882	35,948	80,266	214,553	77,354	(423,768)

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

30. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

f. Risku i normës së interesit (vazhdim)

	Që bartin interes	1 muaj	Prej 1 - 3 muaj	Prej 3 muaj - 1 vit	Prej 1 - 5 vite	Mbi 5 vite	Që nuk bartin interes
31 dhjetor 2018							
Pasuritë financiare							
Paraja dhe balanca me Bankën Qendrore	103,663	38,420	-	-	-	-	65,243
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	20,123	11,668	5,410	3,045	-	-	-
Kreditë dhe paradhëniet për klientët, neto	466,854	13,499	28,372	127,218	221,420	76,345	-
Pasuritë financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	64,733	250	17,667	26,945	18,875	996	-
Pasuritë e përgjithshme financiare	655,373	63,837	51,449	157,208	240,295	77,341	65,243
Detyrimet							
Detyrimet ndaj bankave	392	-	-	-	-	-	392
Detyrimet ndaj klientëve	585,851	8,601	6,821	69,901	96,284	-	404,244
Borxhet dhe huazimet tjera	58	1	3	13	41	-	-
Gjithsej detyrimet financiare	586,301	8,602	6,824	69,914	96,325	-	404,636
Gjithsej hendeku i rivlerësimit të interesit		55,235	44,625	87,294	143,970	77,341	(339,393)

30. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

g. Risku kreditor

Banka i nënshtrohet riskut kreditor përmes aktiviteteve të saj të kredihënies dhe në raste ku ajo vepron si ndërmjetës në emër të konsumatorëve ose palëve të treta ose lëshon garancione. Në këtë drejtim, risku kreditor për Bankën rrjedh nga mundësia që palët e kundërta të ndryshme mund të mos i plotësojnë detyrimet e tyre kontraktuale. Menaxhimi i ekspozimit të riskut kreditor ndaj huamarrësve bëhet nëpërmjet analizave të rregullta të potencialit kreditor të huamarrësit. Ekspozimi ndaj riskut kreditor menaxhohet gjithashtu pjesërisht me marrjen e kolateralit dhe garancioneve.

Ekspozimi kryesor i bankës ndaj riskut kreditor është përmes kredive të saj dhe avanseve për klientët. Shuma e ekspozimit kreditor në këtë aspekt përfaqësohet nga shumat bartëse të pasurive në pasqyrën bilancore. Përveç kësaj, Banka i ekspozohet riskut nga zërat jashtëbilancor kreditor përmes garancioneve të lëshuara.

Përqëndrimet e riskut kreditor (qoftë në ose jashtë bilancit të gjendjes) që rezultojnë nga instrumentet financiare për palën e kundërt kur ata kanë karakteristika të ngjashme ekonomike që mund të shkaktojnë ndikim në aftësinë e tyre për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale ndikohen në mënyrë të ngjashme nga ndryshimet në kushtet ekonomike apo të tjera. Koncentrimet më të mëdha të riskut kreditor paraqiten sipas llojit të klientit në lidhshmëri me kreditë bankare dhe avanset, si dhe garancionet e lëshuara.

Për matjen e mëpasshme dhe zhvlerësimin e pasurive të bankës vlerëson nëse evidenca objektive e zhvlerësimit ekziston individualisht për pasuritë financiare të cilat janë individualisht të rëndësishme, dhe individualisht ose në mënyrë kolektive për pasuritë financiare të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme. Nëse është përcaktuar që nuk ekziston ndonjë evidencë objektive e zhvlerësimit për mjetin financiar të vlerësuar individualisht, e rëndësishme apo jo, përfshijnë mjetin në grupin e mjeteve financiare me karakteristikat e ngjashme të riskut kreditor dhe në mënyrë kolektive i vlerëson ato për zhvlerësim. Mjetet të cilat janë individualisht të vlerësuara për zhvlerësim dhe për të cilën humbja e zhvlerësuar është apo vazhdon të njihet nuk janë të përfshira në vlerësimin kolektiv për zhvlerësim.

Termet dhe kushtet e përdorimit të kolateralit

Kolaterali i mbajtur nën marrëveshjen e kredisë mund të posedohet vetëm nga banka në rast të vonesës nga ana e huamarrësit dhe udhëheqjes së procedurave ligjore në përputhje me legjislacionin e Kosovës që mundësojnë bankën për të marrë titullin e plotë ligjor dhe të pronësisë. Vetëm pas përfundimit të këtyre procedurave, banka mund të shes ose transferoj kolateralin.

Gjithashtu, Banka njeh konfiskimin e kolateralit si një pasuri vetëm kur ajo ka titullin e plotë ligjor dhe posedimin fizik të kolateralit dhe vlerën e drejtë të kolateralit mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme.

Banka nuk mund të shesë, të transferojë apo të ri-zotërojë kolateralin, ndërsa për huamarrësit janë kryer pagesat ose procedura ligjore për transferimin e pronësisë, si rezultat i mospagimit nuk ka përfunduar.

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

30. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

g. Risku kreditor (vazhdim)

Ekspozimi maksimal ndaj riskut kreditor:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Paratë e gatshme, balancat në para në bankat qendrore dhe depozitat e tjera me kërkesë si bankat	114,205	84,743
Pasuritë financiare jo-tregtare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes	-	-
Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	77,312	64,278
Pasuritë financiare me koston e amortizuar	573,081	486,977
Letrat me vlerë të borxhit	-	-
Kredi për qeverinë	-	-
Kredi për bankat	33,008	20,123
Kredi për organizatat financiare	123	203
Kredi për individët	204,742	174,654
<i>Mbitërheqjet e dhena</i>	3,001	3,106
<i>Kredi për shtëpi dhe banesa</i>	139,307	115,019
<i>Kreditë konsumatore</i>	56,815	49,476
<i>Kredi të tjera</i>	5,619	7,053
Kreditë për klientët e tjerë	335,208	291,997
<i>Kreditë për klientët korporatave të mëdha</i>	11,020	69,138
<i>Kredi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme</i>	324,188	222,859
Pasuritë tjera financiare	460	409
Pasuritë e përgjithshme financiare neto	765,058	636,407
Garancionet	22,642	22,811
<i>Garancionet financiare</i>	15,156	15,598
<i>Garancionet jofinanciare</i>	7,486	7,213
Detyrimet kreditore	64,232	2,672
Detyrime të tjera potenciale	3,683	54,226
Gjithsej detyrimet kontingjente	90,557	79,709
Ekspozimi maksimal total ndaj rrezikut të kredisë	855,615	716,166

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

30. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

h. Kreditë dhe avanset

Ekspozimi maksimal total ndaj rrezikut të kredisë më 31 dhjetor 2019

	HPK 12- mujore të kredive	HPK përgjatë jetës-jo të rëna në vlerë	HPK përgjatë jetës- të rëna në vlerë	Pasuritë financiare të blera të rëna në vlerë	Gjithsej
31 dhjetor 2019					
A	299,610	9	-	-	299,619
B	196,287	33,190	-	-	229,477
C	1,988	58,096	-	-	60,084
D and E	-	-	10,937	-	10,937
Lejimet për humbje	(7,864)	(9,770)	(9,402)	-	(27,036)
Vlera kontabël	490,021	81,525	1,535	-	573,081

Ekspozimi maksimal total ndaj rrezikut të kredisë më 31 dhjetor 2018

	HPK 12- mujore të kredive	HPK përgjatë jetës-jo të rëna në vlerë	HPK përgjatë jetës- të rëna në vlerë	Pasuritë financiare të blera të rëna në vlerë	Gjithsej
31 dhjetor 2018					
A	248,742	13	-	-	248,755
B	94,644	59,039	-	-	153,683
C	3,893	93,853	-	-	97,746
D and E	-	-	13,957	-	13,957
Lejimet për humbje	(3,924)	(10,459)	(12,781)	-	(27,164)
Vlera kontabël	343,355	142,446	1,176	-	486,977

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

30. VLERE E DREJTË E TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

h. Kreditë dhe avanset (vazhdim)

Instrumentet e borxhit me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

31 dhjetor 2019	HPK 12- mujore të kredive	HPK përgjatë jetës-jo të rëna në vlerë	HPK përgjatë jetës- të rëna në vlerë	Pasuritë financiare të blera të rëna në vlerë	Gjithsej
A	7,172	-	-	-	7,172
B	70,140	-	-	-	70,140
C	-	-	-	-	-
D and E	-	-	-	-	-
Lejimet për humbje	(846)	-	-	-	(846)
Vlera kontabël	76,466	-	-	-	76,466

Zotimet e huave dhe kontratat e garancisë shtetërore

31 dhjetor 2018	HPK 12- mujore të kredive	HPK përgjatë jetës-jo të rëna në vlerë	HPK përgjatë jetës- të rëna në vlerë	Pasuritë financiare të blera të rëna në vlerë	Gjithsej
A	33,964	1	-	-	33,965
B	48,186	1,849	-	-	50,035
C	245	5,503	-	-	5,748
D and E	-	-	809	-	809
Lejimet për humbje	(1,329)	(299)	(767)	-	(2,395)
Vlera kontabël	81,066	7,054	42	-	88,162

Sistemi i brendshëm i vlerësimit dhe autorizimet

31 dhjetor 2019	Huatë dhe paradhëniet bruto	Huatë dhe paradhëniet %	Humbjet nga zhvlerisimi	Humbjet nga zhvlerisimi (%)
A	299,619	50%	(724)	3%
B	229,477	38%	(9,687)	36%
C	60,084	10%	(7,223)	27%
D and E	10,937	2%	(9,402)	35%
Gjithsej	600,117	100%	(27,036)	100%

Sistemi i brendshëm i vlerësimit dhe autorizimet

31 dhjetor 2018	Huatë dhe paradhëniet bruto	Huatë dhe paradhëniet %	Humbjet nga zhvlerisimi	Humbjet nga zhvlerisimi (%)
A	248,755	48%	(416)	2%
B	153,683	30%	(6,162)	23%
C	97,746	19%	(7,805)	29%
D and E	13,957	3%	(12,781)	47%
Gjithsej	514,141	100%	(27,164)	100%

30. VLERA REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

h. Kreditë dhe avanset (vazhdim)

Kategoria A

Të gjitha kreditë apo shërbimet tjera të drejtpërdrejta kreditore dhe ekspozimet jashtë bilancore që bartin një rrezik normal bankar. Informacionet në dispozicion në lidhje me ekspozimet kreditore, performansën e llogarisë së klientit, dhe të dhënat financiare që të gjitha këto dëshmojnë se shlyerja e ekspozimit është mjaft e sigurtë dhe nuk ka ndonjë vështirësi (apo obligimi është i siguar plotësisht me kolateral të përshtatshëm). Në mënyrë të ngjashme brenda klientëve të vlerësuar në kategorinë A, klientët vlerësimet/ekspozimet të gjitha janë kredi direkte apo objektet dhe ekspozimet jashtë bilancit të bankës të cilat janë pa rrezik. Ekspozimet të cilat kanë si kolateral depozita apo të holla ose një garanci të lëshuar nga një bankë e cila ka një vlerësim të jashtëm të kreditit e rënde BBB, klasën e vlerësuar nga Moody ose S & P agjencive të vlerësimit të kreditit.

Kategoria B- Vrojtuese

Kredi me vëmendje të posaçme (ose Vrojtuese) - Ky klasifikim duhet të përdoret për të identifikuar dhe monitoruar ekspozimet që përmbajnë dobësi apo dobësi potenciale të cilat në rastin e rishqyrtimit, nuk e rrezikojnë kthimin e kredisë apo nuk reflektojnë ndonjë potencial për ndonjë humbje, por të cilat, po qe se nuk adresohen apo nuk korrigjohen mund të rezultojnë në keqësimin e kredisë në nën standard apo klasifikim më të ashpër. Në rast se ka mungesë të ndonjë dëshmie të dokumentuar që është e pafavorshme, apo këto kredi vonohen më shumë se 30 ditë por më pak se 60 ditë atëherë bankat duhet t'i klasifikojnë këto kredi si "Kredi me vëmendje të posaçme", si dhe ato kredi që janë vazhdimisht në mbetje të borxhit në tejkallim të 5% të linjave të aprovuara për më shumë se 30 ditë por më pak se 60 ditë. Kjo kategori e klasifikimit është përpiluar që t'ju mundësojë bankave që të identifikojnë dhe adresojnë marrëdhëniet shumë të dobëta që në fazën e hershme.

Kategoria C- Nën-standard

Nën-standard - Ekspozimet të cilat duke u bazuar në shqyrtimin e analizave të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, janë definuar qartë dobësitë e kredisë të cilat rrezikojnë pagesën e kredisë në një kurs normal. Një kredi Nën Standard është ajo kredi e cila në bazë të analizave të të dhënave financiare si dhe faktorëve të tjerë, nuk është e mbrojtur për momentin nga vlera e shëndoshë si dhe nga kapaciteti i pagesës së huamarrësit apo garantuesit ose vlera e kolateralit. Kërkohet mbështetje nga ana e garantuesve përgjegjës dhe të aftë për të kthyer kredinë gjë që do të përfshinte edhe negociatën të vazhdueshme para se likuidimi i kredisë të kërkojë një klasifikim Nën Standard. Nevoja për të kërkuar mbështetjen e kolateralit si mjet për të shlyer obligimin duhet të jetë bazë për një klasifikim Nën Standard. Në rast se ka mungesë të ndonjë evidence të dokumentuar që është e pafavorshme, një ekspozim duhet të klasifikohet Nën Standard, të paktën nëse kriteret në vijim aplikohen:

- (a) Nëse depozitat / rrjedha e parave në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e papaguar (aktiv) brenda 60 ditëve që nga data e skadimit të kredisë.
- (b) Nëse klienti e ka tejkalluar limitin e autorizuar prej 5% apo për më shumë se 60 ditë pa e paguar këtë tejkallim apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar.
- (c) Nëse klienti vonohet për të paguar këstet e kredisë sipas kontratës (duke përfshirë edhe interesin) për më tepër se 60 ditë.
- (d) Nëse afati i kthimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 60 ditë për arsye të mospagimit.

Kategoria D- Të dyshimta

Të dyshimta - Ekspozimet e dyshimta të cilat duke u bazuar në shqyrtimin e analizave të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, përmbajnë të gjitha dobësitë të cilat janë të qenësishme në kreditë nën standarde, por të cilat theksojnë që ekzistojnë mundësitë e forta që pjesa e rëndësishme e shumës së kështit nuk do të paguhet. Ka mundësi të humbjes, mirëpo shumata e saktë nuk mund të definohet saktësisht në rastin e shqyrtimit apo kjo varet edhe nga shfaqja e ndonjë veprimi apo rasti në të ardhmen. Ndonëse mundësia e humbjes është jashtëzakonisht e lartë, për shkak të faktorëve të rëndësishëm dhe të pazgjithur specifik, por të cilët mund të funksionojnë për të mirën dhe përforsimin e kredisë, klasifikimi i saj si humbje e përafërt mund të shtyhet deri sa të përcaktohet një status më i saktë. Shembuj të faktorëve të tillë përfshihen por nuk janë të limituar në bashkimin, përvetësimin, ristrukturimin e kapitalit, si dhe furnizimin me kolaterale të reja apo plane të reja të refinancimit.

30. VLERA REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

h. Kreditë dhe avanset (vazhdim)

Kategoria D- Të dyshimta (vazhdim) Mbështetje në çfarëdo kolaterali të disponueshëm që nuk do të ishte i mjaftueshëm për të mbuluar shumën gjithashtu mund të arsyetojnë klasifikimin e dyshimtë.

vi. Rënia në vlerë e pasurive financiare

Në rast se ka mungesë të ndonjë evidence të dokumentuar që është e pafavorshme, një ekspozim duhet të klasifikohet si i dyshimtë, të paktën nëse kriteriumet në vijim aplikohen:

- Nëse depozitat / rrjedha e parave në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e papaguar (aktiv) brenda 90 ditëve që nga data e skadimit
- Nëse klienti e ka tejkalar limitin e autorizuar prej 5% apo për më shumë se 90 ditë pa e paguar këtë tejkalimin apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar.
- Nëse klienti vonohet për të kryer pagesën e çfarëdo kësti të kontraktueshëm (duke përfshirë interesin) që tejkalon 90 ditë.
- Nëse ka mungesë në gjendjen financiare të klientit që ka shkaktuar kapital negativ.
- Nëse afati i kthimit/përfundimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 90 ditë për arsye të mospagimit.

Kategoria E – Kreditë e këqija (humbje)

Kreditë e këqija (humbje) - Janë ato ekspozime të cilat janë të bazuara mbi një analizë të të gjithë faktorëve shoqërues të kredisë, kanë vlerë të vogël ose do të kërkojnë një periudhë shtesë për të realizuar ndonjë vlerë dhe nuk janë më të arsyeshme që të mbahen në librat aktive të bankës.

Një ekspozim mund të konsiderohet si i ekspozim i keq (humbje) nëse ndonjë nga kriteret në vijim aplikohet:

- Nëse depozitat/rrjedha e parasë në llogarinë e mbitërheqjes së klientit janë të pamjaftueshme për të likuiduar bilancin e mbitërheqjes të papaguar brenda 180 ditëve nga data e skadimit të mbi tërheqjes.
- Nëse klienti e ka tejkalar limitin e autorizuar të kredisë mbi 5% apo më shumë për mbi 180 ditë pa e paguar këtë mbitërheqje apo nëse menaxhmenti i bankës paraprakisht nuk e ka përcaktuar limitin e autorizuar.
- Nëse klienti vonohet për të kryer pagesën e çfarëdo kësti të kontaktueshëm (duke përfshirë interesin) që tejkalon 180 ditë.
- Nëse afati i kthimit/data e skadimit të kredisë është në vonesë për më tepër se 180 ditë për arsye të mospagimit.

Rënia në vlerë dhe rezervat për pjesën e mbetur të portfolios së ndërmarrjeve, pronarëve individual dhe klientëve të vegjël (kërkesat nga klientët që nuk janë individualisht të rëndësishëm) dhe për kërkesat nga klientët individualisht të rëndësishëm (përveç bankave) për të cilët nuk ka asnjë provë të zhvlerësimit, llogariten në baza grupe (qasja e portfolios). Kreditë në grup janë të ndara më tej në kategoritë, ndërmarrje dhe pronarë të vetëm, grupe të klientëve të vegjël në bilancin e gjendjes. Të gjitha të tri grupet më tej ndahen në pesë nën kategoritë A, B, C, D, dhe E.

Kur një kredi konsiderohet e pa-arkëtueshme, ajo është shlyhet me rezervat përkatëse për zhvlerësimin kreditor. Kredi të tilla shlyhen pasi të gjitha procedurat e nevojshme të kenë përfunduar dhe shuma e humbjes të jetë përcaktuar. Rikuperimet pasuese të shumave të zbritura më parë janë kredituar në pasqyrën e të ardhurave.

Nëse shuma e provizionit për kreditë e provizionuara më pas zvogëlohet për shkak të ndonjë ngjarjeje që ndodh pas shlyerjes, lirimi i provizionit kreditohet në pasqyrën e fitimit dhe humbjes.

Më 31 dhjetor 2019 janë shlyer 2,972 mijë Euro principal të kredive dhe 3 mijë Euro interes, në bazë të rregullave dhe rregulloreve të BQK-së dhe rregulloret dhe standardet NLB Ljublanës. Të gjitha këto kredi të shlyera, janë zhvlerësuar 100%, dhe si të tilla nuk kishin efekt mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019.

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

30. VLERA REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

h. Kreditë dhe avanset (vazhdim)

Efekti i kolateralit në pasuritë financiare që janë të rëna në vlerë më 31 dhjetor 2019:

31 dhjetor 2019	Pasuritë e mbi-kolateralizuara		Pasuritë jo të-kolateralizuara	
	Vlera bartëse e pasurive	Vlera reale e kolateralit	Vlera bartëse e pasurive	Vlera reale e Kolateralit
Pasuritë financiare me koston e amortizuar	1,461	34,711	73	90
Letrat me vlerë të borxhit	-	-	-	-
Kredi për qeverinë	-	-	-	-
Kredi për bankat	-	-	-	-
Kredi për organizatat financiare	-	-	-	-
Kreditë individuale	235	2,258	73	83
Mbitërheqjet e lejuara	-	2	1	1
Kreditë banesore	228	2,115	32	37
Kreditë individuale	7	120	25	45
Kreditë tjera individuale	-	21	15	-
Kredi për klientët e tjerë	1,227	32,453	-	7
<i>Kreditë për ndërmarrje të mëdha</i>	-	-	-	-
<i>Kreditë për ndërmarrje të vogla dhe të mesme</i>	1,227	32,453	-	7
Pasuritë e tjera financiare	-	-	-	-
Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Huatë dhe paradhëniet	-	-	-	-
Gjithsej	1,462	34,711	73	90

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

30. VLERA REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

h. Kreditë dhe avanset (vazhdim)

Efekti i kolateralit në pasuritë financiare që janë të rëna në vlerë më 31 dhjetor 2018:

31 dhjetor 2018	Pasuritë e mbi-kolateralizuara		Pasuritë jo të-kolateralizuara	
	Vlera bartëse e pasurive	Vlera reale e kolateralit	Vlera bartëse e pasurive	Vlera reale e kolateralit
Pasuritë financiare me koston e amortizuar	1,481	37,147	106	100
Letrat me vlerë të borxhit	-	-	-	-
Kredi për qeverinë	-	-	-	-
Kredi për bankat	-	-	-	-
Kredi për organizatat financiare	-	-	-	-
Kreditë individuale	231	2,557	106	99
Mbitërheqjet e lejuara	-	2	2	2
Kreditë banesore	226	2,335	56	57
Kreditë individuale	4	59	32	40
Kreditë tjera individuale	1	161	16	-
Kredi për klientët e tjerë	1,244	34,590	-	1
Kreditë për ndërmarrje të mëdha	330	4,117	-	-
Kreditë për ndërmarrje të vogla dhe të mesme	914	30,473	-	1
Pasuritë e tjera financiare	-	-	-	-
Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Huatë dhe paradhëniet	-	-	-	-
Gjithsej	1,475	37,147	106	100

Analiza e identifikimit të mbi ose nën kreditë e kolateralizuara është kryer nga Banka në vlerën kontabël bruto të kredive. Tabela e mësipërme paraqet totalin e kredive neto ndaj total kolateralit.

Kolaterali i marrë në konsideratë për zbutjen e riskut kreditor përbëhet nga prona të paluajtshme, siç janë toka dhe ndërtesat, dhe pengu për pronat e luajtshme si aksionet dhe çdo pasuri tjetër e luajtshme që mund të konvertohet në pasuri likuide në transaksion duarlrë. Siç përshkruhet nga politika e Bankës për ekspozimin e kredisë, Banka duhet të mbulojë të paktën 163% me pronën rezidenciale dhe/apo 200% me pronë komerciale në korrelacion me vlerën e tregut të kolateralit. Artikujt të cilët nuk kanë risk, të cilat janë kreditë të mbuluara me para të gatshme apo ndonjë aktiv likuid i cili lehtë konvertohet në para në ndonjë transaksion, siç definohet nga politika për riskun e kredisë nga menaxhmenti i Bankes dhe rregullores së BQK-së për ekspozime të mëdha.

Sigurimi i kolateralit merret në konsideratë në procesin e llogaritjes së zhvlerësimit të humbjeve. Tregu real dhe vlerat e likuidimit të kolateralit dokumentohen nga vlerësimi aktual i bërë nga pala kompetente. Mundësia e Bankës të qaset dhe likuidojë kolateralin gjatë një periudhe të arsyeshme konsiderohet gjithashtu. Brenda kolateralit përfshihen pronat e luajtshme dhe të paluajtshme të palës së kundërt, në mënyrë që të mbulojnë ekspozimin ndaj riskut kreditor dhe riskut të dështimit për të shlyer kredinë.

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

30. VLERE REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)**i. Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**

Tabela më poshtë paraqet gjithë portfolion e letrave me vlerë debitore, dhe kategorinë e tyre kreditore të caktuara nga agjensitë për klasifikimin kreditor nga Moody's apo Fitch:

31 dhjetor 2019

Klasifikimet	Pasuritë financiare në vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	Gjithsej
AA	7,172	7,172
A+	665	665
Pa-klasifikuara	70,140	70,140
Gjithsej	77,977	77,977

31 dhjetor 2018

Klasifikimet	Pasuritë financiare në vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	Gjithsej
AA	1,735	1,735
A-	455	455
Not-rated	62,543	62,543
Gjithsej	64,733	64,733

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

30. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

j. Koncentrimet

NLB Banka ka një strategji të kreditit e cila determinon llojet e investimeve (koncentrimeve) duke u bazuar kryesisht në segmentet ekonomike siç janë industria, tregu, ndërtimtari etj. Duke marrë parasysh se Republika e Kosovës është vend i vogël, përqendrimet gjeografike brenda Kosovës nuk janë shumë domethënëse, kjo strategji rishikohet dhe përditësohet në baza vjetore nga bordi menaxhues i bankës.

Tabela në vijim zbërthen ekspozimet kryesore kreditore të bankës në shumat neto të tyre, ashtu siç është kategorizuar nga sektorët industrial të palëve tjera.

Sipas datës 31 dhjetor 2019 dhe 2018, analizat e kredive të klientëve dhe bankave sipas sektorëve industrial ishte si në vijim:

Koncentrimi industrial

	31 dhjetor 19		31 dhjetor 18	
	Kreditë neto	%	Kreditë neto	%
Bankat	33,008	5.8%	20,123	4%
Financat	123	0.0%	202	0%
Qytetarët	204,742	35.7%	174,654	36%
Energjia, gasi, uji	3,152	0.5%	3,136	1%
Ndërtimtaria	56,181	9.8%	52,337	11%
Industria	37,919	6.6%	29,428	6%
Edukimi	1,485	0.3%	1,292	0%
Bujqësia	193	0.0%	25	0%
Miniera	459	0.1%	405	0%
Shërbimet	99,225	17.3%	82,772	17%
Shërbimet – turizmi	9,729	1.7%	9,204	2%
Transporti dhe komunikimet	6,193	1.1%	6,894	1%
Tregtia	116,355	20.3%	103,534	21%
Shërbimi shëndetësor, dhe sigurimi shoqëror	4,318	0.8%	2,971	1%
Pasuritë tjera financiare	460	0.1%	409	0%
Gjithsej	573,541	100%	487,386	100%

k. Risku i Likuiditetit

Rreziku i likuiditetit rrjedh nga financimi i përgjithshëm i aktivitetëve të bankës dhe nga menaxhimi i pozicioneve. Në të përfshihet rreziku i të qenit i paaftë për financimin e mjeteve me maturitet dhe normë të përshtatshme dhe rreziku i të qenit i paaftë që të likuidojë një mjet me çmim të arsyeshëm dhe në kohë të përshtatshme për të përmbushur detyrimet. Banka e monitoron likuiditetin e saj në baza ditore në mënyrë që të menaxhojë pagesën e obligimeve të saj ashtu siç maturojnë sipas afateve të tyre.

Fondet krijohen duke përdorë një numër të madh të instrumenteve përfshirë depozitat, huatë dhe kapitalin aksionar. Kjo e zgjeron fleksibilitetin e financimit, e kufizon varësinë në ndonjë burim të vetëm të fondeve dhe përgjithësisht e ulë koston e fondeve. Banka bën përpjekje të mëdha që të ruaj një baraspeshim në mes vazhdueshmërisë së financimit dhe fleksibilitetit duke përdorur detyrime me maturitete të ndryshme. Banka vazhdimisht e vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshimet në financim të cilat janë të nevojshme që ajo t'i përmbush synimet dhe qëllimet e përcaktuara në strategjinë e përgjithshme të Bankës. Veç kësaj, Banka zotëron një portfolio të mjeteve likuide si pjesë e strategjisë së menaxhimit të rrezikun e likuiditetit. Shumat e paraqitura në tabelat e mëposhtme paraqesin rrjedhat e paskontuara kontraktuale të parasë.

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

30. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

k. Risku i Likuiditetit (Vazhdim)

Analiza e pasurive dhe detyrimeve financiare sipas maturimeve kontraktuale:

Pasuritë financiare	Sipas kërkesës dhe më pak se një muaj	Prej 1 - 3 muaj	Prej 3 muaj - 1 vit	Prej 1 - 5 vite	Mbi 5 vite	Gjithsej
Paraja dhe balanca me Bankën Qendrore	134,204	-	-	-	-	134,204
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	21,221	8,561	2,143	1,083	-	33,008
Kreditë dhe paradhëniet për klientët, neto	16,610	32,138	141,958	258,744	90,623	540,073
Pasuritë financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë	5,802	6,238	9,145	55,061	1,731	77,977
Pasuritë e tjera financiare	460	-	-	-	-	460
Pasuritë e përgjithshme financiare	178,297	46,937	153,246	314,888	92,354	785,722
Detyrimet financiare						
Depozitat nga bankat	594	-	-	-	-	594
Llogaritë e klientit	501,118	10,985	72,964	100,318	-	685,385
Huazimet dhe borxhet e varura	11	4	16	17	15,000	15,048
Detyrime të tjera financiare	5,567	-	-	-	-	5,567
Detyrimet e qirasë	58	126	570	1,873	-	2,627
Gjithsej detyrimet financiare	507,348	11,115	73,550	102,208	15,000	709,221
Pasurite / detyrimet financiare neto më 31 Dhjetor	(329,051)	35,822	79,696	212,680	77,354	76,501
Pasurite financiare						
Shumat kontraktuale të arkëtueshme	130	193	671	1,325	16	2,335
Shuma kontraktuale te pagueshme	2,278	4,365	17,724	47,224	10,872	82,463
	(2,148)	(4,172)	(17,053)	(45,899)	(10,856)	(80,128)
Detyrimet financiare						
Shuma kontraktuale te pagueshme	-	-	-	-	-	-
	226	448	2,485	7,301	1,865	12,325
	(226)	(448)	(2,485)	(7,301)	(1,865)	(12,325)
Pasurite / detyrimet financiare neto	(331,425)	31,202	60,158	159,480	64,633	(15,952)

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

30. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

k. Risku i Likuiditetit (Vazhdim)

Analiza e pasurive dhe detyrimeve financiare sipas afatit të kontraktimit

31 dhjetor 2018	Sipas kërkesës dhe më pak se një muaj	Prej 1 - 3 muaj	Prej 3 muaj - 1 vit	Prej 1 - 5 vite	Mbi 5 vite	Gjithsej
Pasuritë Financiare						
Paraja dhe balanca me Bankën Qendrore	103,663	-	-	-	-	103,663
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	11,668	5,410	3,045	-	-	20,123
Kreditë dhe paradhëniet për klientët, neto	13,499	28,372	127,218	221,420	76,345	466,854
Pasuritë financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	250	17,667	26,945	18,875	996	64,733
Pasuritë e tjera financiare	409	-	-	-	-	409
Pasuritë e përgjithshme financiare	129,489	51,449	157,208	240,295	77,341	655,782
Detyrimet financiare						
Depozitat nga bankat	392	-	-	-	-	392
Llogaritë e klientit	412,845	6,821	69,901	96,284	-	585,851
Huazimet dhe borxhet e varura	1	3	13	41	-	58
Detyrime të tjera financiare	3,697	-	-	-	-	3,697
Gjithsej detyrimet financiare	416,935	6,824	69,914	96,325	-	589,998
Pasuritë / detyrimet financiare neto më 31 Dhjetor 2018	(287,446)	44,625	87,294	143,970	77,341	65,784
Pasuritë financiare						
Shumat kontraktuale të arkëtueshme	6	6	6	-	-	18
Shuma kontraktuale të pagueshme	2,066	3,864	15,900	41,591	9,669	73,090
	(2,060)	(3,858)	(15,894)	(41,591)	(9,669)	(73,072)
Detyrimet financiare						
Shuma kontraktuale të pagueshme	-	-	-	-	-	-
	227	432	1,714	3,174	-	5,547
	(227)	(432)	(1,714)	(3,174)	-	(5,547)
Pasuritë / detyrimet financiare neto	(289,733)	40,335	69,686	99,205	67,672	(12,835)

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

30. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

I. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

a) Vlera e drejtë e Instrumenteve financiare në kosto të amortizuar

SNRF 13 përcakton vlerën e drejtë si çmimin që do të merret për të shitur një pasuri ose për të paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Vlerat reale janë bazuar në supozimet e menaxhmentit bazuar në profilin e mjetit dhe bazën e detyrimit.

Tabela në vijim përmbledhë shumat bartëse dhe vlerat reale të atyre mjeteve financiare dhe detyrimeve që nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozitës financiare në vlerën e tyre reale.

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Shuma bartëse	Vlera reale	Shuma bartëse	Vlera reale
Kreditë dhe avanset e bankave	33,008	33,066	20,123	20,192
Kreditë dhe avanset e klientëve	540,073	559,371	466,854	485,733
Detyrimet ndaj bankave	594	614	392	537
Detyrimet ndaj klientëve	685,385	691,890	585,851	591,626
Huazimet	15,048	22,537	58	59
Detyrimet tjera financiare	8,194	8,194	3,697	3,697

Të gjitha shpalosjet e vlerës së drejtë janë të bazuar në vlerësimet e menaxhmentit dhe teknikave të vlerësimit dhe të bien nën Nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë. Teknikat e vlerësimit dhe vlerësimet për pasuritë dhe detyrimet më kryesore janë të përshkruara më poshtë:

Kredi dhe paradhënie për bankat

Kreditë dhe paradhëniet e bankave tjera përbëjnë plasmane ndërbankare. Vlera reale e plasmaneve dhe depozitat gjatë natës është vlera e tyre bartëse për shkak të natyrës së tyre afat-shkurtë.

Kreditë dhe paradhëniet e klientëve

Kreditë e klienteve në bilancin e gjendjes janë paraqitur në shuma neto, i.e. shtesat neto për zhvlerësime. Për qëllime të kalkulimit të vlerës reale, Banka ka përdorur metodën e zbritur të rrjedhës së parasë. Sidoqoftë, kalkulimi është i bazuar në rrjedhat kontraktuale të parasë. Risku kreditor i klientëve individual merret parasysh përmes rënies në vlerë të pritur.

Depozitat dhe huamarrjet

Përcaktimi i vlerës reale të depozitave dhe huazimeve është i bazuar në rrjedhën e parasë së zbritur kontraktuale, duke marrë parasysh normat kamatore të tregut, të cilat do të ishin të pagueshme nga Banka në rast të nevojës për zëvendësimin e burimeve të vjetra me ato të reja të maturitetit të mbetur të barabartë.

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

30. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

1. Vlera reale e instrumenteve financiare (vazhdim)

b) Vlera reale e Instrumenteve financiare që bartin kosto të amortizuar

Banka i matë vlerat reale duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës reale që reflekton rëndësinë e inputeve të përdorura në matjet me:

- a) **Niveli 1:** Cmimi i kuotuar i tregut (parregulluar) në një treg aktiv për një instrument të njëjtë.
- b) **Niveli 2:** Teknikat e vlerësimit bazuar në imputet e vëzhgueshme të tjera ndryshe nga çmimet e kuotuar, qoftë në mënyrë direkte (dmth si çmimet) ose tërthorazi (dmth rrjedh nga çmimet). Kjo kategori përfshinë instrumentet me vlerë duke përdorur: çmimet e kuotuar të tregut në tregjet active për instrumente të ngjashme: çmimet e kuotuar për instrumentet identike ose të ngjashme në tregjet që konsiderohen më pak active, apo teknika të tjera të vlerësimit ku të gjitha imputet e rëndësishme janë direct ose indirekt të dukshme nga të dhënat e tregut.
- c) **Niveli 3:** Teknikat e vlerësimit duke përdorur inpute të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshinë të gjitha instrumentet ku teknika e vlerësimit përfshinë inputet të pa bazuar në të dhënat e vëzhgueshme dhe inputet e pa-vëzhgueshme që kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshinë instrumentet që janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumente të ngjashme, ku kërkohen rregullime dhe supozime të pavëzhgueshme për të pasqyruar dallimet midis instrumenteve.

Tabela në vijim paraqet shpërndarjen e vlerave reale përgjatë hierarkive të ndryshme të vlerave reale.

31 dhjetor 2019	Gjithsej Vlera	Niveli 1	Niveli 2	Niveli
Pasuritë financiare				
Instrumentet e borxhit	77,312	7,172	70,140	-
Instrumentet e ekuitetit	665	-	665	-
Gjithsej pasuritë financiare përmes të ardhurave tjera gjithëpërfshirë	77,977	7,172	70,805	-
31 dhjetor 2018	Gjithsej Vlera	Niveli 1	Niveli 2	Niveli
Pasuritë financiare				
Instrumentet e borxhit	64,278	-	64,278	-
Instrumentet e ekuitetit	455	-	455	-
Gjithsej pasuritë financiare përmes të ardhurave tjera gjithëpërfshirë	64,733	-	64,733	-

Çmimet e vëzhgueshme të tregut dhe të hyrat e modelit në dispozicion zvogëlojnë nevojën e gjykimit dhe vlerësimit të menaxhmentit dhe poashtu, zvogëlojnë edhe pasigurinë e shoqëruar me përcaktimin e vlerave të drejta. Çmimet e vëzhgueshme të tregut dhe të hyrat në dispozicion ndryshojnë varësisht nga produktet dhe tregjet dhe kanë prirje ndaj ndryshimeve në bazë të ngjarjeve specifike dhe kushtet e përgjithshme në tregjet e ardhshme.

Banka nuk posedon instrumente që janë subjekt i lëvizjeve të mundshme nga një nivel në tjetrin të kategorisë së vlerës së drejtë.

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE SIPAS SNRF
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

31. ANALIZA E MATURIMIT TË PASURIVE DHE DETYRIMEVE

Tabela më poshtë tregon një analizë të pasurive dhe detyrimeve të analizuara sipas kur pritët të rikuperohen ose shlyhen.

Pasuritë	31 dhjetor 2019			31 dhjetor 2018		
	Brenda 12 muajve	Pas 12 muajve	Gjithsej	Brenda 12 muajve	Pas 12 muajve	Gjithsej
Paraja dhe balanca me Bankën Qendrore	134,204	-	134,204	103,663	-	103,663
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	31,925	1,083	33,008	20,123	-	20,123
Kreditë dhe paradhëniet për klientët, neto	190,706	349,367	540,073	169,089	297,765	466,854
Pasuritë financiare të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	21,185	56,792	77,977	44,862	19,871	64,733
Pasuritë e tjera financiare	822	-	822	800	-	800
Prona pajisjet dhe e drejta e perdorimit të pasurive	-	13,721	13,721	-	10,870	10,870
Pasuritë e paprekshme	-	1,032	1,032	-	659	659
Tatimi i shtyrë	248	-	248	426	-	426
Gjithsej pasuritë	379,090	421,995	801,085	338,963	329,165	668,128
Detyrimet						
Detyrimet ndaj bankave	594	-	594	392	-	392
Detyrimet ndaj klientëve	585,067	100,318	685,385	489,567	96,284	585,851
Detyrimet tjera financiare	6,321	1,873	8,194	3,697	-	3,697
Provizionet dhe detyrimet tjera	5,374	1,445	6,819	536	5,808	6,344
Tatimi i pagueshem i te ardhurave te korporates	118	-	118	-	-	-
Huamarrjet dhe borxhet e varura	31	15,017	15,048	17	41	58
Gjithsej detyrimet	597,505	118,653	716,158	494,209	102,133	596,342
Net	(218,415)	303,342	84,927	(155,246)	227,032	71,786

32. NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT

Bordi Menaxhues i Bankës në Mars 2020 ka planifikuar të propozojë në Asamblenë e Përgjithshme shpërndarjen e fitimit të vitit 2019, 70% të fitimit neto sipas metodologjisë së BQK-së.

Asnjë ngjarje tjetër materiale pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar nuk ka ndodhur që kërkojnë shpalosje në pasqyrat financiare.

NLB Banka sh.a.
Rr. Ukshin Hoti nr. 120
10 000 Prishtinë

T: +383 38 240 230 100
E-mail: info@nlb-kos.com
Internet: nlb-kos.com
SWIFT: NLPRXKPR

NLB Banka sh.a. Prishtinë

Prishtinë, Prill 2020

474+ TË PUNËSUAR
LJUBLJANA
KËSHILLË FINANCIARE
SHËRBIME DIGJITALE
24/7
SIGURI
PËRSOSMËRI
NLB M-KLIK
SPONSORIME
SHËRBIME DIGJITALE
VEPRA TË MIRA
SHËRBIME DIGJITALE
GARANZIONE BANKARE
PËRGJEGJËSI
SOCIALE CSR
ASETET
BANKINGU SARAJEVA
BANKING ONLINE
KËSHILLË FINANCIARE
NLB PAY KULETA DIGJITALE
SHËRBIME DIGJITALE
PRISHTINA EDUKIMI FINANCIAR
35 DEGË CRM
PROFESIONAL
DERI TANI B2B
SPONSORIME
VEPRA TË MIRA CSR
PRISHTINA
KËSHILLË FINANCIARE
LEHTË
NLB M-KLIK
SPONSORIME
TË HYRAT KAMATORE B2C
EKOLOGJI
GARANZIONE BANKARE
EDUKIMI FINANCIAR
BESIM
B2B
PRISHTINA
24/7
WIN-WIN
DERI TANI
BANKINGU
SPONSORIME
DIVIDENDA
RRITJE
SIGURI
SHKUP
NLB E-KLIK
PROFESIONAL
PODGORICA
SIGURI
24/7
B2B
PROJEKTE RAJONALE
RRITJE
LEHTË
RRITJE
NLB PAY KULETA DIGJITALE
DERI TANI
BESIM
NJOHURI
BANKING MOBIL
DERI TANI
BESIM
NJOHURI